

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

VEHBI MIFTARI

**ETNOLETRA SHQIPE**

Raporti i letërsisë me etnokulturën e kombformimin

---

BOTIMET TOENA



AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

VEHBI MIFTARI

ETNOLETRA  
SHQIPE



Raporti i letërsisë me etnokulturën  
e kombformimin

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2025

Botuese: Irena Toçi

Redaktore shkencore: Majlinda Toçi

Përkujdesja grafike *dhe* kopertina: Adriana Matraku

ISBN 9789928809643

ISBN 9789928817921

© Vehbi Miftari, 2025

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij libri nuk mund të riprodhohet pa leje paraprake.

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

Shëtitörja Murat Toptani

Tiranë 1000

BOTIMET TOENA

Rr. “M. Gjollështa” nr. 71, Tiranë 1023.

Kutia Postare 1420

E-mail: [botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[toena.porosionline@gmail.com](mailto:toena.porosionline@gmail.com)

<https://toena.al/>

# TREGUESI I LËNDËS

PARATHËNIE .....	7
<b>LIBRI I: LETËRSI E PËRKATËSI</b> .....	25
I. LETËRSIA NË TEHUN E TEORIVE MBI KOMBFORMIMIN .....	31
Kombet kulturore dhe kombet politike .....	32
<i>Etnosimbolizmi</i> .....	43
<i>Modernizmi</i> .....	51
<i>Perenializmi</i> .....	61
<i>Primordializmi</i> .....	65
Teoritë bashkëkohore .....	66
II. ROLI I LETËRSISË NË KRIJIMIN E PËRKATËSIVE KOMBËTARE .....	69
Kujtesa e përbashkët: pasqyrimi në këngë.....	70
Etnomitet: identifikimi me simbolikën e përbashkët .....	76
Histori e letërsi .....	81
<b>LIBRI II: HUMANISTËT E FILOBIBLISTËT</b> .....	85
LETËRSIA PËRKATËSORE E HUMANISTËVE .....	87
Marin Barleti .....	91
Dhimitër Frangu .....	114
LETËRSIA PËRKATËSORE E FILOBIBLISTËVE .....	121
Gjon Buzuku .....	130
Pjetër Budi .....	135
Pjetër Bogdani .....	138
Autorë të tjerë .....	146

<b>LIBRI III: ROMANTIKËT E PASROMANTIKËT</b> .....	151
ROMANTIZMI DHE PËRKATËSITË PARARENDËSE .....	153
Përkatësitë pararendëse .....	153
<i>Humanizmi e renesanca</i> .....	155
<i>Reformacioni e kundërreformacioni</i> .....	159
<i>Revolucioni francez</i> .....	164
<i>Iluminizmi</i> .....	166
“PËRKATËSIA” ROMANTIKE .....	171
Rizgjimi kulturor romantik .....	173
Shqipëria shpirtërore .....	186
KUJTESA DHE PËRKATËSIA ROMANTIKE .....	197
Kujtesa epike .....	198
<i>Këngët kreshnike</i> .....	199
Kujtesa historike .....	205
De Rada: “ <i>Moti i Madh</i> ” .....	206
Zef Skiroi: <i>Kushtrimi për atdhe</i> .....	212
Naim Frashëri: <i>Istori e Skënderbeut</i> .....	213
Ndoc Nikaj: “ <i>Ringjallja</i> ” e kombit .....	221
At Zef Pllumi: <i>Kujtimet e fëmijërisë</i> .....	222
Kujtesa zakonore – juridike .....	226
Shtjefën Gjeçovi: <i>Kanuni i Lek Dukagjinit</i> .....	227
Kujtesa poetike .....	230
Koliqi: <i>Poetika e mallit</i> .....	231
Kujtesa politike .....	232
Noli: <i>Jetëshkrimi politik</i> .....	232
MITI DHE PËRKATËSIA ROMANTIKE .....	237
Miti i origjinës së lashtë .....	237
Miti i ripërtëritjes / “Nderi etnik” .....	252
Miti i gjuhës .....	255
HIMNET KOMBËTARE – “FRYMA E PËRBASHKËSISË” .....	277
Shpirti i kombit / “Kënga e kombit” .....	278
“Loja” - Simbolet .....	289
PËRFUNDIME .....	291
TREGUESI I EMRAVE .....	309
BIBLIOGRAFIA .....	316

## PARATHËNIE

**K**ur nisa kërkimin mbi raportin që krijimtaria, para së gjithash ajo gojore ka zhvilluar historikisht me përkatësitë, atë gjuhësore, kulturore, fetare e politike, kisha vënë re se studimet mbi letërsinë, të kurthuara brenda katedrave albanologjike, e kishin thujtë të panjohur qasjen ndërdisiplinare për studimin e dukurive letrare. Kjo mungesë ndërveprimi me fushat e tjera i kishte kufizuar dijet mbi letërsinë e kulturën, ngaqë i trajtonte ato si krijimtari artistike, por linte anash ndikimin e saj si mjet shprehjeje të pikëpamjeve sociale, kulturore e filozofike dhe për forcimin e pikëpamjeve të kombit mbi vetveten.

Kisha vënë re, po ashtu, se studimi i letërsisë (sidomos i letërsisë së hershme shqipe) lidhej vetëm ndonjëherë me shtresa kulturore. Edhe kur bëhej, anashkalohej thelbi i tyre: ndikimi i një kulture të hershme (popullore) në bartjen e formave të letërsisë, nga ajo gojore në atë të shkruar. Kësisoj, pamundësohej njohja e shpirtit popullor, ndjenja e tij, kujtesa e besimi (përfshirë mitet) në studimin e letërsisë së hershme shqipe.

Ofrimi i një qasjeje të re, e cila krijimtarinë letrare do ta trajtonte në raport me dijet historike, filozofike e humane jo vetëm mundësonte që letërsia të merrte peshë brenda trashëgimisë historike dhe kulturore të shqiptarëve, por do të ndihmonte edhe në sqarimin e raporteve që ajo ka me pikëpamjet kulturore, letrare e historike të tyre.<sup>1</sup>

---

1. Një sprovë të parë të këtyre raporteve e kam botuar në vitin 2017, nën titullin *Letra e identitete* ("99aikd", Prishtinë, 2017). Përmbajtja e saj, e plotësuar, është përfshirë ►

Isha i vetëdijshëm se as dijet mbi zhvillimin e kombeve s’kishin si të kuptoheshin e të shpjegoheshin mirëfilli pa i trajtuar ato të ndërlidhura me krijimtarinë letrare. Letërsia shqipe ishte zhvilluar e pashkëputur nga synimet e kombit shqiptar, ndërkohë që u kishte shërbyer qëllimeve kulturore lokale (në bashkësitë kulturore të veriut, gjatë shekujve XVI-XVII), ose synimeve politike (në lëvizjen romantike, gjatë shekullit XIX), duke krijuar një lloj simbioze me këto pikëpamje. Pra, një lloj filli që e mbante atë të ndërlidhur me pikëpamje politike e kulturore e ka përcjellë vazhdimisht zhvillimin e saj.

Por, kjo nuk ka ngjarë vetëm me letërsinë shqipe. Përgjithësisht, letërsitë nacionale janë zhvilluar pashkëputshëm nga zhvillimi historik i kombeve në gjirin e të cilëve kanë lindur. Pra, letërsia ka krijuar një raport historik me zhvillimin e kombit dhe me pikëpamjet e tij. Këto synime, të cilat, sikur dihet artikulohe në forma të ndryshme me kalimin e kohës, përcillen edhe me ndryshime në artikulin e tyre artistik. Periudha e humanizmit pati synime të tjera nga ato të romantizmit, sikurse letërsia filobibliste<sup>2</sup> duhet të ketë shfaqur synime krejtësisht të ndryshme nga iluminizmi e modernizmi. Megjithatë,

- 
- ◀ në pjesë të ndryshme të këtij libri. Disa rezultate i kam paraqitur edhe në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë e Kulturën Shqiptare (Shih: *Etnoletra shqipe - miti, gjuha dhe kujtesa në letërsinë shqipe, nga humanistët te pasromantikët*, Seminari XXXVI Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Nr. 35/2017, fq. 619-643; <https://www.ceeol.com/search/article-detail?id=734210>; *Barleti - kujtesa e rrëfyeme (facts and fiction in "History of Scanderbeg)*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Nr. 36, 2017, pp. 371-386, <https://www.ceeol.com/search/article-detail?id=683139>; *Andrra romantike: Nation in potentia*, Seminari XXXVIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Nr. 38 / 2019; *Romantizmi dhe "identitetet e tjera"*, revista *Gjurmime albanologjike*, Seria e shkencave filologjike, Instituti Albanologjik, nr. 48/2018, Prishtinë, 2019; fq. 203-214, <https://www.ceeol.com/search/article-detail?id=772203>; *Kujtesa historike në kangët kreshnike*, në: *Gjurmime albanologjike*, Folklor dhe etnologji, Instituti Albanologjik, nr. 48/2018, Prishtinë, 2019; fq. 45-54, <https://www.ceeol.com/search/article-detail?id=771953>.
2. Me letërsi filobiblike kuptohet letërsia e shkruar nga autorë të hershëm shqiptarë, të cilët tekstet e veta i mbështetën në shkrimin biblik, duke pasur parabazë e paramodel Biblën. Studiuuesi Sabri Hamiti mendon se ky përngjasim ►



qoftë synimet e kombit, qoftë format e artikulimit artistik të ndjenjave të anëtarëve të tij, mbeten të lidhura me disa qëllime *tejhistorike* (tejkohore) dhe me një kulturë të hershme, shtresuar në truallin e të parëve etnikë.

Letërsia e shkruar shqipe lindi ngaqë në tokën e arbitrit që shtresuar tashmë një traditë popullore, si sinkretizim i traditës lokale dhe kulturës fetare. Ajo mundësoi shfaqjen e *lokales* dhe *autentikes* brenda kulturës universale, të cilën mesjeta e shihte të simbolizuar në institucionin e kishës. Zvetënimi i latinishtes si gjuhë e literaturës dhe e liturgjisë, kthimi i ngadaltë dhe i pashmangshëm i saj në gjuhë të administratës, rreziku që kishat e vendit ta humbnin lidhjen me grigjën (e cila kishte gjithnjë e më shumë vështirësi që të kuptonte predikimin në gjuhën latine), si dhe shtysa e madhe që protestantizmi, në njërën anë, dhe shpikja e shtypshkronjës, në anën tjetër, i dhanë synimit për të “njohur Zotin” në gjuhën (gjuhët) e vendit, bënë që Selia e Shenjtë jo vetëm të lejonte predikimin e fesë në gjuhët vernakulare, por edhe të nxitte përkthimin e botimin e teksteve liturgjike në këto gjuhë.

Ngjashëm me popujt e tjerë, edhe arbitrit përkthyen e shkruan tekste, të cilat jo vetëm krijuan parabazën për kapërcimin nga kultura gojore shqipe në atë të shkruar, por përcaktuan edhe vetë karakterin e saj, si letërsi me parabazë të fuqishme biblike - letërsi filobiblike. Shkrimtaria e tyre u shndërrua në lidhëse mes kulturës së vendit dhe synimeve të njerëzve.

Nëse, megjithatë, po themi se letërsitë rriten në shtratin e pikësnyimeve të bartësve të tyre dhe janë të lidhura me pikëpamjet e kombeve mbi vetveten, pra shprehin artistikisht ndjenjën e tij, a mund të themi se letërsia është mjeti që ruan dhe kultivon kujtesën e kombeve? Nëse po, a do të thotë se duke qenë “kujdestare” e këtyre ndjenjave, ajo rrezikon të marrë funksione të tjera nga ai i vërteti, që është krijimi i një bote të veçantë nëpërmjet shprehjesh artistike? Pra, nëse po themi se synim i letërsisë nuk është shpalosja e ndjenjave të kombit, por krijimi i një

---

◀ prek “subjektin, modelin dhe shprehjen letrare”. Shih: Sabri Hamiti, Letërsia filobiblike - Shkrimtarët filobiblikë, në: *Vepra letrare 7* (“Faik Konica”, Prishtinë, 2002), fq. 19.

bote të mundshme, e cila i ngjason jetës reale ose e ripërtërin atë, në dimensione të reja, dhe në të njëjtën kohë po e pranojmë se ajo (letërsia) mund të bartë karakterin historik dhe pikëpamjet politike të kombeve mbi veten e tjetrin, a mos po rrëshqasim në një kundërshti në synimet tona?

Duke ecur teht të moskuptimit e mospajtimit me këto dy gjendje, libri shtron pikërisht këtë raport mes letërsisë së frymës nacionale dhe prirjes *ripërtëritëse* të kombeve, të aplikuar mbi një tip letërsie e mbi një korpus veprash letrare: letërsinë e hershme shqipe (humanistët e filobiblistët) dhe atë romantike. Të parën e zgjedha ngase mundëson shqyrtimin e zanafillës së mendimit të autorëve të hershëm shqiptarë mbi bashkësitë kulturore, gjuhësore e fetare; të dytën, për të hetuar artikulimin e pikëpamjeve mbi jetësimin e kombit dhe të instrumentit të tij politik: shtetit. Afërmendsh, zgjedhja ishte e pëlqyer dhe e imponuar njëkohësisht: letërsia (e shkruar) shqipe është zhvilluar mbi një traditë të pasur gojore, e pashkëputur nga pikëvështrimet epike. Kjo e bën atë pjesë të vorbullës së letërsive që janë zhvilluar përbri fatkeqësive historike, duke u bërë herë pararendëse e herë pasuese e tyre, pa mundur të shkëputej asnjëherë sojesh.

\* \* \*

Libri është i ndarë në tri pjesë, ose në tre “libra”. I pari trajton raportin mes letërsisë e fatit historik të kombeve, të përjetësuar në epikën gojore ose në letërsinë e shkruar dhe ndikimin që ajo ka pasur në zhvillimin e vetëdijes për përkatësi (kulturore, fetare, gjuhësore e etnike, deri tek ajo kombëtare). Duke mbajtur parasysh se ky libër nuk u ofrohet vetëm studiuesve, ose lexuesve idealë,<sup>1</sup> por edhe lexuesit të zakonshëm, pa njohuri të thelluara mbi natyrën, format e letërsisë e mbi teoritë mbi kombformimin, ose mbi raportin mes krijimtarisë artistike dhe pikëpamjeve mbi vetveten, libri merr si pikënisje për trajtimin e epikës gojore si *shtrat të kujtesës kolektive* dhe ndikimin

---

1. Shih: Umberto Eco, *Lector in fabula - La cooperazione interpretativa nei testi narrativi* (Bompiani, 1979).

që letërsia, më saktësisht eposi heroik, ka luajtur në procesin e krijimit të kombeve. Më saktësisht, nxitet nga një premisë, në të cilën arrinte studiuesja Anne-Marie Thiesse. Pasi kishte studiuar mënyrat e krijimit të kombeve, ajo kishte arritur në përfundimin se epika gojore është bartëse dhe artikuluese e kujtesës së kombeve, pra e bart trashëgiminë e tyre shpirtërore dhe e bën atë nënshtresë kulturore, mbi të cilën kombet e artikulojnë historikisht të kaluarën e tyre. Në epikën gojore, thoshte ajo,<sup>1</sup> dëgjohet vazhdimisht “jehona e shekujve” dhe shpaloset kujtesa e përbashkët. Kjo premisë që pika nga e cila doja të trajtoja mënyrën se si trashëgimia shpirtërore e shprehur në këngë, duke u bartur brez pas brezi shndërrohet në mjet për ripërtëritje të kujtesës kolektive e në mjet kërkimi për qëllimet e bashkësive etnike. Prej kohësh isha bindur se ky raport që aq i fuqishëm sa mund të ketë ndikuar pashmangshëm në përfundimin e idesë së përbashkësisë.<sup>2</sup>

Libri i parë e trajton këtë raport mes kujtesës e këngës epike. Ato i sheh të lidhura një në përpjekjen e bashkësive për të ringjallur të kaluarën, e për të krijuar model frymëzimi për brezat. Duke u kënduar në këngë, nga njëri brez tek tjetri, trashëgimia përforcohet, duke u mundësuar brezave të ardhshëm që të krijojnë kuadrin legjendar-historik mbi të shkuarën e vet. E kënga, duke kaluar gojë më gojë e nga brezi në brez, shndërrohet jo vetëm në mjet shprehjeje artistike, por edhe në tejkohshmëri, arkistrukturë, që i shtyn njerëzit të besojnë në disa vlera të përbashkëta dhe ta ndiejnë të afërm tjetrin që beson në to. Kështu lind kujtesa e përbashkët, ose kujtesa kolektive. Brezat e ardhshëm do të gërmojnë në të për të gjetur rrënjët e hershme. Sa më thellë në histori që të shtrihen këto rrënjë, aq më e fuqishme bëhet dëshira për dëshmim

- 
1. Shih: Anne-Marie Thiesse, *La création des identités nationales - Europe, XVIII<sup>e</sup>-XX<sup>e</sup> siècle* (Éditions de Seuil, Mars 1999). Cituar sipas përkthimit në gjuhën shqipe: Anne-Marie Thiesse, *Krijimi i identiteteve kombëtare - Europa e shekujve XVIII-XX*, përkthyer nga: Etleva Shiroka (“Dukagjini”, Pejë, 2004), fq. 25-27. Shih edhe: Ismail Kadare, *Autobiografi e popullit në vargje* (“Naim Frashëri”, Tiranë, 1980).
  2. Nocionet “përbashkim”, “përbashkësi”, këtu, tipologjizojnë një proces e një gjendje. Origjinarisht ato janë të ngjashme me “përkatësinë e përbashkët”, të përdorur nga Max Weber, e të trajtuar nga etnosimbolistët. Shih: Max Weber, *Studies in sociology*. Cituar sipas përkthimit në gjuhën shqipe: Max Weber, *Studime sociologjike*, përkthyer nga: Enida Rusi (“Plejad”, Tiranë, 2004).

të tyre e për shpalosjen e tyre, si dëshmimi të ekzistencës së lashtë.<sup>1</sup> Kësisoj, ajo shndërrohet në mjet për ripërtëritje etnike dhe mban të gjallë *frymën*, ndjenjën për të përbashkëtën.

Për të argumentuar këtë lidhje të përhershme mes kujtesës kolektive dhe kapërcimit të saj në mjet motivues për brezat nëpërmjet këngëtimit epik, kam marrë si model librin e Makfersonit, *Poemat e Osianit*,<sup>2</sup> të njohura ndryshe si *këngët osianike*.<sup>3</sup> Sikur dihet, këto këngë frymëzuan lëvizje të mëdha kulturore dhe ndikuan në përforcimin e ndjenjës për të përbashkëtën tek anëtarët e bashkësive të ndryshme etnike. Në të njëjtën mënyrë trajtohen edhe këngët kreshnike shqiptare dhe tradita e pasur epike-legjendare, për të hetuar se si kanë ndikuar në përforcimin e ndjenjës së përkatësisë ndër shqiptarët, duke qenë se shprehin norma sjelljeje që përcaktojnë horizontin e ekzistencës së malësorit të veriut të Shqipërisë dhe raportin ndërmjet njeriut e bashkësisë. Në disa raste, sidomos në traditën arbëreshe, ato janë pasuruar edhe me elemente fetare, duke i shndërruar ato në këngë popullore-fetare. Në to, krahas përmbajtjes epike e ndjenjës së fuqishme, shprehet edhe patos, përlulje e përkushtim ndaj asaj që epi e shpreh si përmbajtje.<sup>4</sup>

Më tej libri e trajton këtë lidhje shumëfishe mes kujtesës kolektive e këngëtimit epik, në raport me zhvillimin historik të bashkësive etnike dhe ndikimin në zhvillimin e bashkësive kulturore e etnike, më saktësisht në përforcimin e përkatësisë të tyre.<sup>5</sup> Libri provon të dëshmojë se mes fatit historik të kombeve e natyrës së letrave ka pasur

1. Miti i lashtësisë ka qenë një artific intelektual që mbështeste pretendimet territoriale dhe të drejtën për të pasur shtet. Sa më i vjetër kombi, aq më legjitime konsiderohej e drejta e tij për të jetuar politikisht i pavarur në një territor të dhënë.
2. James Macpherson, *The Works of Ossian, the Son of Fingal*, London, 1765.
3. Shih: "Fragments of Ancient Poetry, Collected in the Highlands of Scotland", *Literary Encyclopedia*, 2004 (shfletuar më 29.01.2022).
4. Për traditën e këngëve popullore-fetare tek arbëreshët, shih: Atë Antonio Bellusci, *La poesia religiosa popolare tra gli italo-albanesi* (Poezia fetare popullore e arbëreshëve), revista "Lidhja", Kozencë, Itali, 1980, fq. 3.
5. Eposi, sidomos ai i kreshnikëve, është dukuri lokale dhe, rrjedhimisht nuk ka qenë faktor në farkëtimin e kombit. Intelektualët e përdorën atë për ta ngritur në kult kombëtar. Veçse, fakti që një dukuri kulturore lokale përvetësohet nga komb-bërësit dhe shndërrohet në pasuri kombëtare nuk do të thotë se është kultivuar gjithandej në të njëjtën përmasë ose se është njohur nga të gjithë. "Përvetësimi" ►

historikisht një lidhje simbiotike. Kjo lidhje ka ndikuar reciprokisht: bashkësitë (fetare, kulturore, gjuhësore e deri tek ato etnike) në letërsi kanë gjetur mjetin për shprehje të pikëpamjeve mbi rolin e tyre historik, ndërsa letërsia është frymëzuar vazhdimisht nga pikëpamjet e tyre mbi këtë rol, duke marrë dikur edhe karakterin e një *letërsie të frymës kombëtare*.<sup>1</sup>

Për të argumentuar idenë se letërsia në të njëjtën kohë “bart” dhe “nxit” ndjenjën e përkatësive,<sup>2</sup> jam pikënisur nga debati i hershëm, asnjëherë i mbyllur tërësisht, mes dy shkrimtarëve gjermanë, Herderit<sup>3</sup> e Gëtes,<sup>4</sup> të cilët përplaseshin rreth idesë nëse letërsia duhet ta pasqyrojë shpirtin e kombit (të jetë kombëtare - Herderi), apo duhet të trajtojë temat e përgjithshme të njerëzimit (të jetë universale - Gëteja). Sado që debati nuk zhvillohej mbi përkatësinë, por për llojin e saj, duket sheshazi se kemi dy koncepte të ndryshme, të cilat mund të përdoren si argument për të parë se si është zhvilluar mendimi mbi letërsinë dhe rolin e saj në shoqëri të caktuara ose se si ajo mund t’i shërbejë mbarë njerëzimit: Gëteja pohonte universalitetin e qenies njerëzore. Ai nuk

---

◀ ndodh si rrjedhojë e teknologjive të reja dhe përhapjes së gjerë të botimeve (Shih: Andersonin, i cit.). Po kështu, edhe eposi mund të përdoret nga bashkësitë etnike për të krijuar bashkësi të përfytyruara.

1. Letërsinë e frymës kombëtare në letrat shqipe e kam trajtuar në mënyrë të veçantë mbi tekstet eseistike dhe kritike të Krist Malokit. Shih: Vehbi Miftari, *Maloki - fryma nacionale në letërsi* (“Shpresa”, Prishtinë, 2006).
2. Përgjatë gjithë librit kam vënë në dukje diskutimin mbi lloje të ndryshme të përkatësive. Në raport me zhvillimin historik të letërsisë shqipe, kam theksuar disa sosh: atë gjuhësore për filobibliotët dhe atë etnike e kulturore për romantikët.
3. Johann Gottfried Herder (1744-1803), filozof dhe teolog gjerman, i cili njihte paradigmen e traditës teksta e shihte letërsinë si “kujtësë të kombit”, ndërsa në veprat osianike dhe në ato të Shekspirit gjente parimet e krijimit të një *letërsie kombëtare*. I formuar nën ndikimin e fuqishëm të këngëve osianike, ai luftonte për “lartësimin e kombit gjerman” nëpërmjet përmendjes së kulturës së trashëguar të tij. Pra, ai ia njihte letërsisë rolin e patjetërsueshëm në formimin e kombit, përmes rilindjes së poezisë popullore, të cilën nuk e shihte si art të vdekur, si dhe gjuhës së kombit, si “shprehje të gjallë, organike, të një populli”.
4. Johan Wolfgang von Goethe (1749-1832), shkrimtar gjerman, ndër më të rëndësishmit e letërsisë gjermane dhe asaj të përbotshme. Ai ngulmonte se letërsia nuk duhej të shihej si shprehëse e kujtësës kombëtare dhe e shenjave etnonacionaliste, por si fushë e përbashkët e njerëzimit.

e zhvishte njeriun nga përkatësia, vetëm se e zhvendoste qendrën e rëndesës te njerëzorja, duke u udhëhequr kështu nga mesazhi universalist i krishterë.

Herderi, në anën tjetër, i mëshon kulturës lokale, duke shmangur krishterimin si parim universalist. Romantikët i kundërvihen universalizmit të krishterë të veshur me petk sekularist duke e theksuar lokalen, jo universalen. Kombi si projekt kulturor dhe politik del nga kjo kundërvënie.

Në gjykimin që shtron ky libër, letërsia i për afron këto dy pikëpamje: është universale për nga natyra, por shtron artistikisht pikëpamje të bartësve të saj, në ide e përmbajtje. Prandaj, hamendësimi se çfarë mendojnë vetë pjesëtarët e kombit mbi raportin që arti i tyre e ka me zhvillimin e tyre, është i pashmangshëm.

Më tej, libri shtron për diskutim raportin e letërsisë me krijimin e kombeve e zhvillimin historik të tyre. Për këtë qëllim trajtohen fillimisht teoritë kryesore të kombformimit, nga etnosimbolistët, modernistët, primordialistët e perenialistët, te teoritë bashkëkohore, e pastaj edhe ndikimi i ndërsjellë mes pikëpamjeve të kombeve për veten e tjetrin dhe letërsisë si mjet shprehjeje artistike. Natyrisht, libri i shtron përmbledhtas konceptet themelore mbi kombformimin,<sup>1</sup> për të parë jo vetëm ndryshimet themelore nga njëra-tjetra, por edhe ndikimin që ato së bashku, ose secila veç e veç kanë pasur në nxitjen e krijimtarisë artistike, po e quajmë, të frymës nacionale.

Në mënyrë të veçantë do të trajtohet ndryshimi themelor ndërmjet etnosimbolistëve dhe modernistëve, ngase këto dy teori shfaqin pikëpamje krejtësisht të ndryshme për zhvillimin e letërsisë, por edhe për mënyrën e të kuptuarit të funksionit të saj në shoqëri. E para, etnosimbolizmi e sheh kombin modern të ndër kallur në një traditë etnike dhe simbolike paraprake. Sipas tyre, pa etnos vështirë se do të mund të flitej për ekzistencë të kombit. Për ta, *kultura e përbashkët* paraqet bërthamë primordiale, mbi të cilën përfitohet kombi. Ajo fillimisht shtrihet e kultivohet si *kulturë*. Më pas,

---

1. Objekt studimi këtu nuk është shpjegimi i teorive mbi kombformimin, detyrë kjo e shkencave politike e sociologjike, por aftësia e tyre për të hetuar një raport të pashmangshëm që zhvillimi i kombeve, sidomos në fazat primordiale të tij, ka pasur me krijimtarinë (para së gjithash gojore) dhe ndikimin e dyanshëm mes tyre.

duke u këngëtuar e bartur si kujtesë kolektive, ajo arrin të trajtohet si përkatësi kulturore, më saktësisht, në përkatësi etnokulturore, në kujtesë të përhershme, e cila shihet si bërthamë për përafrimin e anëtarëve të bashkësive etnike. Pra, etnosimbolizmi e nje natyrën e kombeve si të trashëguar (vetë kombet e prejardhura nga kultura e trashëguar, ndërkaq, i trajton si *kombe kulturore*). Për ta shpjeguar këtë lidhje kulturore me synimet e bashkësive për veten, është marrë në trajtim kryesisht vepra e Anthony D. Smith-it.<sup>1</sup>

Sipas modernistëve, para së gjithash Benedikt Andersonit, Erik Hobsbaunit e Ernest Gellnerit, kombet janë produkt i zhvillimit të shoqërisë dhe i pikëpamjeve të tyre politike. Ata krijohen si rrjedhojë e vullnetit të lirë të anëtarëve të bashkësisë dhe legjitimitit të përditshëm të tij, zhvillimit industrial (e bashkë me të edhe të atij medial, urban e social) dhe homogjenizimin e ngadaltë të anëtarëve të bashkësive, të cilat jo domosdoshmërisht kanë të kaluar të përbashkët historike, ose lidhje gjaku, por njëjtësohen me vlerat të cilat i ndajnë si rrjedhojë e zhvillimit të tyre. Për Andersonin, revolucioni industrial modern, përfshirë më vonë edhe zhvillimin e hovshëm të mediave, në shekullin XVIII solli një vetëdije të re të bashkësive mbi vetveten dhe ndihmoi përafrimin e tyre në struktura politike. Kombet për të janë imagjinare, ato formohen në rrjedhë historike dhe nuk kanë parabazë të përbashkët etnike a kulturore. Anëtarët e saj besojnë në zhvillimin industrial dhe te fuqia e medias për të shpërndarë informacionin mbi të. Kësisoj, ata e kujtojnë veten pjesë të një bashkësie (imagjinare), në të cilën besojnë dhe të cilën e quajnë të veten.

Sa më i fuqishëm dhe më i shpejtë të jetë ky zhvillim industrial, aq më e lehtë bëhet që anëtarët e një grupi homogjen ta “projektojnë” veten si anëtarë të një bashkësie, i cili i kultivon të njëjtat vlera me anëtarët e tjerë. Pra, ai vetidentifikohet me anëtarët e tjerë, edhe pse prejardhja dhe e kaluara e tyre mund të jenë të ndryshme nga e tija. Ai i pranon pikëpamjet e reja mbi bashkësinë imagjinare sikur të ishin të tijat dhe pranon të njëjtësohet me të tjerët, të cilët mund të jenë ndryshe nga ai, por me të cilët ndan pikëpamje të njëjta (ose të ngjashme).

---

1. Shih: Anthony D. Smith, *Ethno-Symbolism and Nationalism - A cultural approach* (“Routledge”, London, New York, 2009), fq. 25.

Vetidentifikimi (si rezultat i zhvillimit) ndikon në shkrirjen e kulturave ekzistuese në një kulturë të re, e cila bëhet dominuese. Ajo i shkrin kulturat e mëhershme (pra, edhe dallimet e trashëguara) dhe përforcon pikëpamje mbi një kulturë të re, përkatësore. Hobsbaumi besonte se revolucioni frëng dhe ai amerikan e kishin përforcuar idenë kombëtare të bashkësive etnike,<sup>1</sup> por kompaktësimi i tyre u bë i mundur vetëm falë zhvillimit të hovshëm industrial. Ai u shndërrua në shtysën vendimtare për formimin e kombit. Legjitimimi politik i kombit (fryt i kulturës së shtresuar dhe i vetëdijes kombëtare) është rezultat i ngritjes së një vetëdijeje të re mbi vetveten. Kështu lindin *kombet politike*.

Pikëvështrimi që ndjek libri në raport me këto teori është se, ndërkohë që kombet janë moderne, rrënjët e tyre nuk janë krejt të stisura, por ruajnë vazhdimësinë nga e shkuara, pra nuk janë thjesht ekonomike, sikundër thonë marksistët, ose Ernest Gellneri, por formësohen mbi shtresime kulturore. Shtysa për jetësimin e tyre, sidoqoftë, janë lëvizjet nacionale. Argumentimi është i thjeshtë, besoj: kombet duhet të kenë pasur pararendës historikë edhe nëse janë krijuar si rezultat i zhvillimit industrial dhe i përcaktimit politik. Nëse sot do ta trajtojmë një komb si kulturor ose politik, pra nëse është formuar mbi një trashëgimi kulturore ose është produkt i një vetëdijeje të re, moderniste, do të varet nga rrugëtimi i tyre drejt kombformimit e kombkonsolidimit. Sikur dëshmon libri, në Europën Juglindore, kombet janë kryesisht rezultat i vetëdijes mbi ekzistencën historike të bashkësive etnike dhe promovimin e ideve mbi to nëpërmjet lëvizjeve nacionaliste.

Diskutimi me teoritë mbi kombformimin na ndihmon të kuptojmë se kultura e shtresuar (etnokultura) dhe nacionalizmi (pikëpamjet moderne mbi kombin) i japin shtysë jo vetëm zhvillimit të krijimtarisë letrare, por edhe karakterit të tyre. Prandaj, njohja e tyre paraprakisht e ndihmon lexuesin të kuptojë më lehtë materien që shtrohet në “librin” e dytë: raportin e letërsive (kombëtare) me përkatësitë, përfshirë atë kombëtare. Por, duke qenë se qasja që ndjek libri është holistike dhe

---

1. Sipas modernistëve, ideologjia dhe nacionalizmi janë historike, por kombet janë produkt i zhvillimit të njerëzimit.



historike njëkohshëm, këto raporte shtrohen të aplikuara mbi letërsinë shqipe, duke e ndjekur fillin historik të saj: nga shkrimtaria humaniste tek ajo postromantike.

Në raport me përkatësitë, libri provon të trajtojë premiset mbi të cilat ka funksionuar historikisht kjo letërsi: për shkrimtarinë e humanizmit libri nxjerr në pah parimet estetike në përpjekjen për “dëshmim” historik të bëmave epike të heronjve; për atë filobibliste rolin e gjuhës e të letërsisë në krijimin e bashkësive kulturore; për romantikët trajton raportin që kjo periudhë ka krijuar me ideologjinë (jo: ideologjinë) kombëtare e me nacionalizmin si shtysë (moderniste) për formimin e kombeve. Synimi: dëshmimi se pavarësisht se kombformimi dhe krijimtaria shpirtërore (letrare) duken si fusha të shkëputura nga njëra-tjetra, pa pikëprekje të dukshme, ato kanë ndihmuar lindjen dhe zhvillimin e njëra-tjetrës.

Për secilën nga këto periudha libri ngre nga një hamendësim teorik, të cilit provon t’i japë përgjigje në kapituj të veçantë. Duke qenë se trajton tri periudha kohore, secila sosh i përgjigjet njërit nga hamendësimet e mëdha: Mesjeta shtron dilemën nëse krijimtaria gojore mund ta bartte barrën e “dëshmimit” të bëmave epike dhe kur parimet estetike humaniste kërkonin portretizimin e heroit si të moralshëm e të dobishëm. Si argument merret shkrimtaria humaniste e Dhimitër Frangut dhe Marin Barletit, të cilët e portretizonin heroin kombëtar të shqiptarëve, Gjergj Kastriotin, si strumbullar jo vetëm të rezistencës ndaj furisë osmane, por edhe si ideolog rreth të cilit mund të krijohet “lidhja”, homogjenizimi i bashkësive që kishin një rrënjë të përbashkët etnike: atë të arbërorëve mesjetarë.

Për shekujt pasues, kur estetika mbështetej në parimet e *iluminatio*-s (dritës hyjnore), shtrohet pyetja nëse fakti se latinishtja i thërriste në ndihmë gjuhët vernakulare për të shpëtuar ose mbajtur gjallë kulturat lokale, u mundësonte autorëve si Buzuku, Budi e Bogdani ta shpërfaqnin këtë dritë në përkthimet/tekstet e tyre në arbërisht, duke e bërë të pranueshëm (të domosdoshëm, madje) të përfillurit e pikëpamjeve etnike në tekstet e veta dhe nëse kjo kishte rol vendimtar në krijimin / përforcimin e bashkësive (fetare popullore) arbëreshe.

Për letërsinë romantike, ndërkaq, thelbësor mbetet hamendësimi nëse ajo mund ta ngjallte atë tip letërsie “misionare” përmbi këtë

kulturë të shtresuar<sup>1</sup> nga një pikëvështrim më kombëtar, sipas parimit të modernistëve. Libri provon të dëshmojë se kjo shtysë është e dukshme gjithandej letërsisë së romantikëve shqiptarë. Mjafton të shfletohen pikëpamjet estetike të De Radës, letërsia e Naimit (madje, edhe epi i Fishtës) për të kuptuar këtë një të pashkëputshme mes letërsisë e pikëpamjeve të kombit shqiptar për vetveten. Nyja që i lidh këto hamendësime është besimi se nacionalizmi, sikur ka dëshmuar romantizmi, shndërrohet edhe në shtysë për nxitjen e krijimtarisë shpirtërore (letrare).

“Libri” i dytë trajton letërsinë e hershme shqipe (humaniste e filobibliiste). Nga humanistët janë marrë si model dy librat<sup>2</sup> e Marin Barletit, *Rrethimi i Shkodrës* dhe *Histori e Skënderbeut*, si dhe ai i Dhimitër Frangut, *Komentari i luftërave të turqve dhe i Zotëri Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, princ i Epirit*.<sup>3</sup> Përcaktimi për veprat Barletit e të Frangut në diskutimet për raportet e letërsisë me pikëpamjet e popujve mbi përkatësitë, e bën të pashmangshëm hamendësimin nëse është e mundur që *shkrimtaria*<sup>4</sup> e humanistëve të ndërlidhet me homogjenizimin e kombit, aq më tepër kur në gjykimin e lexuesit,

- 
1. Përmes rilindjes së kulturës klasike.
  2. Sipas historiografisë letrare të derisotme, Barleti ka shkruar gjithsej tre libra, dy nga të cilët: *Rrethimi i Shkodrës* (1504) dhe *Histori e Skënderbeut* (1508-1510), trajtojnë subjekt shqiptar, ndërsa i treti, *Mbi jetët e papëve dhe perandorëve* (dihet vetëm data e botimit të dytë, 1555), trajton subjekt të huaj. Aurel Plasari, duke iu referuar Nortonit, i vë datë tjetër librit të Barletit: *rreth 1515-1522*.... Shih: Aurel Plasari, *Skënderbeu - Një histori politike* (“IDK”, Tiranë, 2018), fq. 23.
  3. *Gli illustri e gloriosi gesti e vittoriose imprese fatte contro i Turchi dal Signor Don Georgio Castriotto detto Scanderbeg, Principe d’Epiro*, botuar edhe me titullin *Comentario de le cose de’ Turchi, et del S. Georgio Scanderbeg, Principe d’Epyrro*, botuar në shtypshkronjën e gjermanit Erhard Ratdolf, Venedik, 1539. A. Plasari përmend disa botime, i pari nga të cilët i përket vitit 1539. Shih: Aurel Plasari, *Skënderbeu...*, e cit., fq. 27. Libri është përkthyer në gjuhën shqipe nga Hysen Hidri. Shih: Dhimitër Frangu, *Komentari i luftërave të turqve kundër Skënderbeut* (“Globus R.”, Tiranë, 2000).
  4. Këtu nuk mund të flasim për letërsi, *letra*, në kuptimin e krijimtarisë artistike, por për *shkrimtari*, tekste të diskutuese të tjera, para së gjithash atij historik. Por, duke qenë se, sikundër dëshmohet te Barleti, fillimi i shkrimtarisë me diskurs historik i nënshtrohet parimit të fuqishëm estetik humanist, diskursi i tyre anon jo rrallë nga ai gjysmëletrar.

shkrimtaria e humanizmit lidhet me diskursin historik dhe jo me atë letrar. Gjithashtu, ajo është shkruar në gjuhë tjetër, atë latine, dhe jo në gjuhën shqipe.

Atëherë, mbi çfarë kriteri shkrimtaria e humanizmit është përfshirë në studimin e raporteve komb-nacionalizëm-krijimtari? Ka disa arsye: së pari, humanistët (edhe ata shqiptarë) kërkonin modelin e ripërtëritjes kulturore e artistike, e cila mund të vinte nga drita hyjnore, shpirtërisht, dhe nga modelet e hershme, kulturalisht. Skënderbeu i Barletit dhe i Frangut qe modeli i krijuar përmbi këtë vetëdije humaniste, por i lidhur për tokën e njerëzit e tij. Së dyti, modeli i heroit që priret drejt parimeve klasike do të mbetej një model “i papërkatësi” nëse autorët e tij (Barleti e Frangu) nuk do të prireshin që tekstet e veta t’i shtronin sipas parimeve estetike humaniste, edhe pse në gjuhën latine, por me subjekt shqiptar. Madje, ata e bënë të qartë se po shkruanin tekst për heroin arbëror, që bëmat e tij të mos harroheshin dhe të ngjallnin shpirtin e bashkëkohësve të tij. Pra, modeli i Skënderbeut qe modeli arbëror i heroit, i mbujtur me vlerat e humanizmit.

Për filobibliotët libri mban parasysht një paradigmë kulturore: letrarësia (shkrimtaria) e tyre është e lidhur me ekzistencën e një *kulture popullore* të krishterë, e cila e ka mundësuar lindjen e veprave të para letrare, krahas politikave të papatit për të lejuar botimin e librave në gjuhët vernakulare. Pra, veprat e para shqipe janë rezultat i ekzistencës së një kulture të krishterë, e organizimit të jetës në Arbëri dhe e nxitjes së klerikëve që ta përjetësojnë atë në vepra të shkruara.

Por, si ka ndikuar kjo kulturë në lindjen e teksteve të para shqipe? A mos është pretendim i lartë t’i atribuohet asaj lindja e letërsisë së shkruar shqipe? Aspak.

Së pari, shekujt XVI dhe XVII janë shekujt e shtrirjes së furisë osmane në tokat e arbrit dhe ruajtja e kulturës së krishterë ishte shndërruar në thelbin e jetës për arbërorët. Prandaj, ata kultivonin katolicizmin, fenë dhe traditën e krishterë si shenjë të fuqishme përkatësore. Ndërkohë, kisha e vendit përballej me vështirësi të mëdha mbijetese, si rrjedhojë e mungesës së klerit të shkolluar dhe vështirësive në organizimin e jetës kishtarë. Megjithatë, kjo kulturë ishte shndërruar në kulturë popullore të vendit. Kjo nënkuptonte përdorimin e gjuhës shqipe (arbërishtes) në

liturgji, në mënyrë që anëtarët e këtyre bashkësive ta kuptonin atë dhe të mund të merrnin pjesë në ceremonitë fetare. Latinishtja, si gjetiu, edhe në tokat e arbrit po e humbte fuqinë dhe lindja e një kulture të re, më popullore, e mbështetur në gjuhën dhe traditat e vendit po bëhej e pashmangshme. Ky proces, kompleks, që lidhej me konsolidimin e një klase drejtuese arbërore, po shpinte në krijimin e një kulture përfaqësuese, që përfshinte shtresa të ndryshme të popullatës. Për ta shpërndarë atë kërkoheshin tekste në gjuhën e vendit.

Për filobibliistët janë trajtuar tri “B”-të e mëdha: Buzuku, Budi e Bogdani,<sup>1</sup> të cilët shihen si produkt i ekzistencës së kësaj tradite kulturore, ku feja ishte e lidhur me kulturën e vendit e kjo me përkatësinë. Buzuku, prijës i teksteve të shkruara në gjuhën shqipe, provoi që kulturën fetare (në formë formulash kishtarë, uratash e lutjesh) ta kthente në kulturë të shkruar, duke përkthyer tekst liturgjike në gjuhën shqipe. Ai qe bartës i një kulture kishtarë popullore e lëvrues i formave të shkruara të saj, duke qenë edhe autori i parë që e bën kapërcimin nga format tradicionale gojore në atë të shkruar.

Synimi i teksteve të filobiblistëve, sikur u nënvizua, ishte që arbërve t’u ofroheshin tekste liturgjike në “gluhën e vendit”, nxitur edhe nga vetë kisha katolike e Romës, e cila nën presionin e lëvizjeve protestante, në njërën anë, dhe humbjen e ngadalshme të latinishtes si gjuhë e kishës dhe kthimin e saj të ngadaltë në gjuhë të administratës, në anën tjetër, jo vetëm po lejonte, por edhe po nxiste botimin e teksteve në gjuhët amtare. Në anën tjetër, shtypshkronjat tashmë po zëvendësonin murgjit kopjues dhe kjo i kishte dhënë shtysë botimit të teksteve në gjuhët e ndryshme.

- 
1. Krahas tyre, libri trajton edhe krijimtarinë e Frang Bardhit, Jul Varibobës e ndonjë tjetri, për aq sa veprat e tyre u shërbejnë qëllimeve të librit. Meqë tashmë janë botuar edhe dorëshkrime të panjohura të autorëve të vjetër, qofshin ato tekste artistike, qofshin tekste liturgjike, ose tekste autobiografike, libri plotësohet edhe me veprat e këtyre autorëve. Kemi parasysh këtu botimet më të reja të studiuesit Matteo Mandalà mbi autorët e vjetër: *Lekë Matranga - Njeriu, koha, vepra* (“Ombra”, Tiranë, 2012); *Gjurmime filologjike për letërsinë e vjetër arbëreshe* (“Çabej”, Tiranë, 2006); *Veprat letrare arbërisht të Nikollë Ketës* (“Ombra”, Tiranë, 2005), por edhe libra si: *Dokumente për historinë e Shqipërisë (1623-1653)*, transkriptuar e përkthyer nga Injac Zamputi (“Faik Konica”, Prishtinë, 2015), ose *Relacione dhe dokumente për historinë e Shqipërisë (1610-1650)*, transkriptuar e përkthyer nga Injac Zamputi (“Faik Konica”, Prishtinë, 2018).

Në anën tjetër, një traditë popullore fetare (katolike) po bëhej strumbullar i lëvizjeve gjuhësore, kulturore, fetare e politike njëkohshëm: ajo po krijonte mundësinë që kleri të zhvillonte liturgjinë në gjuhën e grigjës; nëpërmjet përkthimit e botimit të teksteve liturgjike në gjuhën e vendit, ata po i jepnin karakter social gjithë vendit; në të njëjtën kohë po hidhnin themelet e letërsisë së shkruar shqipe dhe po forconin ndjenjën përkatësore të arbërve. Pra, lidhja rreth fesë, botimi i teksteve në gjuhën e vendit dhe kultivimi i traditës nga kleri u shndërruan në pikënisje për letërsinë e shkruar shqipe (fillimisht me parabazë biblike).

Në “librin” e tretë është trajtuar letërsia e romantizmit, përfshirë edhe pasromantikët, për aq sa ata ndërlidhen me synimet e librit. Ai përfshin periudhën e krijimit të një vetëdijeje të re mbi rolin historik të bashkësive etnike e kulturore. Të shtyra edhe nga ideja e rilindjes së kulturës së hershme, ato artikulojnë qëndrimin e tyre mbi kombin e konsoliduar.<sup>1</sup> Miti i bëmave të hershme epike,<sup>2</sup> pastaj këngëtimi epik dhe rrëfimtaria gojore krijuan bazë për një kulturë, e cila synon ringritjen (kulturore e etnike). Në atë kohë, raportet mes synimeve të kombit dhe kulturës kombëtare marrin formën e “marrje/dhënie”-ve të përhershme. Prandaj, mes idesë mbi përkatësinë dhe artikulimin letrar si formë shprehjeje e “bashkësive” mbi vetveten, shndërrohen në platformë për jetësim të përkatësisë kulturore e politike në shtetin kombëtar, i cili kulturën e hershme, kujtesën, historinë dhe traditën i trajton si “shtresime të tejkohshme” mbi të cilat mund të zhvillojë *jetën kombiare*.<sup>3</sup> Këto shtresime të hershme, *arkistruktura*, romantizmit i qenë ofruar nga formacionet e mëhershme kulturore (humanizmi e renesanca); filozofike (iluminizmi); politike (revolucionin frëng dhe ai amerikan); kishtarë (reformacioni e kundërreformacioni). Ato i shërbyen romantizmit si struktura pararendëse (arkistruktura), mbi të cilat mund të artikulohej platforma për lindjen (a konsolidimin) e kombeve dhe, rrjedhimisht, edhe të kulturës kombëtare. Për këtë arsye, “libri” i tretë

1. Me togfjalëshin “komb i konsoliduar” nuk synohet të përmbysset rendi i njohur në historinë e kombeve, sipas të cilit *kombkonsolidimi* është proces i cili pason (nuk i paraprin) *kombformimin*. Në këtë kuptim, këto dy procese shihen si të pandashme, rrjedhojë logjike e njëra-tjetrës.
2. Në letërsinë shqipe ai lidhet me Motin e Madh, kohën e Skënderbeut.
3. Nacionin e atë Anton Harapit.

fillimisht trajton raportin që romantizmi ka zhvilluar me periudhat e mëhershme (pararendëse), të cilat e kanë shtresuar kujtesën për rolin e bashkësive etnike e kulturore në histori dhe në krijimin e një vetëdijeje mbi veten dhe reflektimin që kjo vetëdije ka pasqyruar në letërsi. Zgjimi kulturor romantik, si rimarrje e riartikulim i rezultateve të këtyre periudhave pararendëse, dhe pasqyrimi në letra i ideve kombëtare-politike e kombëtare-kulturore në romantizëm, është objekti themelor i “librit” të tretë. Secila nga këto “përkatësi” paraprijëse trajtohet në mënyrë të veçantë, sa për t’i hetuar paradigmat mbi të cilat janë krijuar ato, po aq për t’i parë lidhjet e tyre strukturore (arkistrukturore) me romantizmin, të cilat bënë të mundur zgjimin kulturor romantik.

Por, pse qenkan kaq të rëndësishme këto përkatësi kulturore, fetare, filozofike e politike, ndërsa po flasim për romantizmin? Ngase, zgjimi kulturor romantik, i krijuar përmbi to, u mundësoi kombeve kthimin nga vetvetja dhe krijimin e një raporti të përhershëm me trashëgiminë e tyre. Kërkimi i rrënjëve të hershme, këngëtimi epik, ndërloja me narrativën popullore dhe ringjallja e epikës historike u bënë premisa të pakapërcyeshme për kërkimin e një përkatësi të re, asaj romantike. Kjo ndërlidhje përbën dimensionin e dytë të rëndësishëm, që trajton “libri” i tretë.

Folklori, sikur është thënë në krye të tekstit, qe mjete të cilin kombet e shfrytëzuan për të ringjallur madhësinë e hershme, por edhe modeli të cilin shkrimtarët romantikë e përdorën si model në krijimet e tyre. Përngjasimi në varg e në strukturë mes poezisë popullore dhe asaj të romantikëve, është jo vetëm i dukshëm, por edhe i kuptueshëm. Shqiptarët kanë zhvilluar kulturë të hershme dhe të pasur popullore. Ata e kanë ruajtur e kultivuar folklorin si mjet për dëshmim e ripërtëritje. Mbledhja e tij, prandaj, u bë njëri nga synimet e romantikëve, ndërsa krijimi sipas modelit të rapsodive të hershme, art i dëshiruar. Vetë De Rada, më i hershmi e më i madhi artikulues i ndjenjës romantike shqiptare, i krijoi veprat e veta mbështetur në këtë model. Synimi: ringjallja e shpirtit shqiptar dhe i “dëshmisë”<sup>1</sup> për trashëgiminë e hershme. Kësisoj, kënga u shndërrua në mjet për artikulim e mobilizim,

---

1. Në pikëvështrimin e romantikëve kënga (këngëtimi epik) ringjall kujtesën historike.

njëkohshëm. Libri analizon strukturën e këngëve kreshnike, për të hetuar praninë e kujtesës historike në to, si dhe ndikimin që kjo kujtesë ka pasur në zgjimin romantik.

Të vetëdijshëm se këngëtimi epik nuk e përcakton qartë arealin historik dhe as ngjarjet historike e bartësit e tyre dhe se historia është shtypa themelore për ringjalljen e ndjenjës kombëtare, njohja e veprave themelore historiografike u bë imanencë. Prandaj, libri merr në shqyrtim kërkimet historike, mbi të gjitha librin *Histori e Shqypnis* të Ndoc Nikajt,<sup>1</sup> nëpërmjet të cilit mund të shtrihet kërkimi për atë që Grosby e quante *thellësi kohore* (temporal depth).<sup>2</sup> Kërkimi në thellësinë historike, veprim i pëlqyer nga romantikët, i shpuri ata (De Radën në letrat shqipe) deri te kërkimi i *impulseve të hershme organike*,<sup>3</sup> kombin e lashtë, dëshmimi i të cilit nënkuptonte jo vetëm praninë e tyre në histori, por edhe afirmimin e së drejtës së tyre për të jetuar të lirë e të mosvarmë.

Roli i letërsisë në shpалosjen e këtyre “impulseve organike” bëhet jetik, sikundër që gjuha shndërrohet në mjet të fuqishëm për krijim përkatësie e mjet mbijetese. Duke e *rrëfye t’kaluemen* ajo shndërrohet në mjet lidhjeje mes kujtesës (historike), përkatësisë (etnosimbolike) dhe synimeve politike. Libri i trajton këto dimensione në veprat e autorëve të mëdhenj romantikë: De Radës e Naim Frashërit, deri te shkrimet e hershme të Fishtës e shkrimet e Pashko Vasës (Vaso Pashës).

- 
1. Ndoc Nikaj, *Historia e Shqypnis - ch' me fillëse e déri me kohe ku ra ne dore te turkut*, Bruksel, Perlindia e Shqypetarevé, 1902. Cituar nga: Ménnimé te shtypesit, në: Ndoc Nikaj, *Historija e Shypnis*, vëllimi I-II (“Gjergj Fishta”, Lezhë, 2015).
  2. Steven Grosby, *Nationalism - A Very Short Introduction* (Oxford University Press, University of Oxford, 2005), fq. 8.
  3. Shih: Philip Schwyzer, *Literature, Nationalism and Memory* (Cambridge University Press, UK, 2004).





LIBRI I:  
LETËRSI E PËRKATËSI



Ndërsa po trajtonte krijimin e përkatësive kombëtare, studiuesja Anne-Marie Thiesse<sup>1</sup> arriti në përfundimin se këngëtimi epik, i bartur si trashëgimi gojore, ka rol të jashtëzakonshëm në procesin e kombformimit. Duke u bartur brez pas brezi, këngët epike dëshmojnë për trashëgiminë dhe e shndërrojnë atë në mjet për përforcim të idesë së përbashkësisë. Thiesse dëshmonte se në letra (letërsi) dëgjohet vazhdimisht jehona e “epopesë së ardhur nga thellësia e shekujve”, kujtesa e njerëzve që ndiejnë afri me njëri-tjetrin dhe provojnë ta dëshmojnë këtë nëpërmjet rrëfimit gojor, të cilin ua bartin si trashëgimi të përbashkët brezave të ardhshëm.<sup>2</sup>

Kësisoj, kënga shndërrohet në mjet të cilin në stadet e hershme të homogjenizimit kombet e kanë përdorur për të dëshmuar se ndërmjet grupeve të njerëzve ekzistojnë disa lidhje, të cilat ata i shndërrojnë në “anëtarë” të fisit/grupit, me bëma e kujtesë të përbashkët. Ato i përdorin si dëshmi e mjet për lidhje gjithnjë e më të fuqishme mes anëtarëve të

- 
1. Shih: Anne-Marie Thiesse, *Krijimi i identiteteve kombëtare...*, e cit., fq. 25-27.
  2. Në kulturën shqiptare, krijimtaria popullore është e hershme dhe bartësja kryesore e rrëfimit për vetveten. Sipas Gaetano Petrotës, “aj zë fill nga vetëdija etnike, e brendshme, e popullit shqiptar”. Shih: Gaetano Petrotta, *Svolgimento storico della cultura e della letteratura albanese* (Palermo, 1950). Cituar sipas botimit në gjuhën shqipe: Gaetano Petrotta, *Zhvillimi historik i kulturës dhe letërsisë shqipe*, përkthyer dhe përgatitur për botim nga: Qemal Velija (“Reklama”, Tiranë, 2020), fq. 55.

tyre. Pra, kënga u shërben si mjet për përafrim gjithnjë e më të madh rreth disa vlerave të përbashkëta, edhe kur ato barten ndërdijshëm dhe nuk qesin krye si kriter i pashmangshëm për organizimin e jetesës kolektive. Ajo i rrëfen bëmat epike të heronjve dhe u mundëson anëtarëve të një bashkësie ringjalljen e kujtimit për historinë e përbashkët. Kësisoj, ajo kthehet sa herë që anëtarët e një bashkësie e ndiejnë të nevojshme ta “ridëshmojnë” praninë e tyre historike, ose kur dëshirojnë ta theksojnë lidhjen e pashkëputshme, tejhistorike, mes synimeve të bashkësisë dhe jetesës së tyre. Ajo mundëson ringjalljen e kultit të të parëve, i cili, sikur shprehej Ernest Renan,<sup>1</sup> është kulti më legjitim mbi të cilin kombet projektojnë synimin e tyre për t’u organizuar në shoqëri të veçantë, e cila ka një trashëgimi epike, disa heronj epikë, disa këngë të cilat i përjetësojnë ata dhe një gjuhë në të cilën rrëfejnë për veten.

Meqë këngëtimi është gojor, ai bartet nga brezi në brez, duke i marrë reliktet e mëhershme dhe duke i shndërruar ato në nënshtresë për motivim të ri. E, duke u motivuar nga bëmat e heronjve epikë, brezat e rinj lidhen për fatin historik të pararadhësve të tyre, njëjtësohen me ta, bëhen pjesë e historisë së përbashkët dhe, rrjedhimisht, edhe e së tashmes së përbashkët.

Shembull se si historia e kujtuar nëpërmjet këngëve epike është shndërruar në mjet përafrimi mes anëtarëve të një gjuhe, kulture e tradite janë poemat epike, të botuara nga poeti skocez, Xhejms Makferson (James Macpherson), nën titullin *Poemat e Osianit*, të njohura gjerësisht si *këngët osianike*. Të mbledhura me pasionin prej rrëfimtari,<sup>2</sup> ato bartin jehonën e “bëmave (epopesë) të ardhura nga thellësia e shekujve”, të cilat teksti letrar i shndërron në tejkohshmëri. Atyre u referohen vazhdimisht anëtarët e bashkësive etnike, kulturore, religjioze ose etnike, si pararendëse të bashkësive të organizuara politike: kombeve.

- 
1. Ernest Renan, Çfarë është kombi?, ligjëratë e mbajtur në Sorbonë, më 11 mars 1882. Shih: Ernest Renan, “What is a Nation?”, në: Ernest Renan, *Qu’est-ce qu’une nation?*, Paris, Presses-Pocket, 1992 (translated by Ethan Rundell), [http://ucparis.fr/files/9313/6549/9943/What\\_is\\_a\\_Nation.pdf](http://ucparis.fr/files/9313/6549/9943/What_is_a_Nation.pdf) (shfletuar së fundi më: 19.01.2022).
  2. Nga këngët galike të shekullit III Makfersoni kishte marrë vetëm emrat e personazheve. Përmbajtja e këngëve dhe motivet qenë krijime të tij.

Makfersoni pretendonte se kishte mbledhur epopenë e heroit legjendar, Oisin. Fillimisht ai kishte mbledhur dhe botuar disa këngë epike mbi heroin mitik. Këngëve për të u referohej si “poemë antike”, kërkimin për të cilën e vazhdoi për dhjetëvjetësja të tërë, derisa, sikur thotë vetë, “zbuloi” jo vetëm historinë e Osianit, por edhe epikën e plotë gojore mbi heroin Fingal, i cili në të vërtetë qe krijuar nga vetë Osiani. *Fingal* u shndërrua në epin qendror të koleksionit mbi “jehonën e shekujve”, të cilën këngët e Osianit ia bartin modernitetit. Ngjashëm me modelin antik të Homerit, *Iliada*, këto këngë u shndërruan në model të vyer për romantikët, të cilët kërkimin e përkatësive e mbështetën në zbulimin e “rrënjëve të hershme”, modelin e përkryer të së cilave e gjenin në këngët epike.

Të përkthyer në gjuhë të ndryshme, këngët osianike frymëzuan lëvizje kombëtare dhe ndikuan në përafrimin e njerëzve rreth përkatësisë së tyre kombëtare. Nëpërmjet simotrave të tyre, popujt e ndryshëm nisën gjurmimin e një lloj narrative historike mbi vetveten dhe “karrocën mbretërore” që do të mund ta bartte atë. I pari mjet i tillë, i cili pati fuqinë ta shpaloste nurin e kësaj creature historike të quajtur *kujtesë kolektive* qenë këngët epike, modelin e së cilave e gjejmë edhe në letërsinë shqipe. Ato janë modeli më i vyer i pasqyrimin të projeksionit të kombeve për veten e i madhështisë së dikurshme të tyre, por edhe i pikëpamjeve të tyre për jetën. Në ciklin e këngëve kreshnike shqipe, ta zëmë, ky mall shpalos një synim: përforcimin e përkatësisë mbi këtë mall historik.

Ngjashëm me traditën homerike dhe atë osianike, popujt e ndryshëm nisën të gërmonin në kujtesën e vet për t’i gjetur rrënjët e kulturës e të historisë mbi të cilën do të thurnin këngën për veten. “Karroca e artë” e këngëve epike, në të cilën do të ruheshin historia, mitet, tradita e gjuha, i barti shenjat identifikuese të popujve dhe ndikoi në krijimin e përkatësive nacionale.



## I. LETËRSIA NË TEHUN E TEORIVE MBI KOMBFORMIMIN

Letërsia lind në shtratin e kulturës, përmbi kujtesën të cilën bashkësitë gjuhësore, kulturore, fetare dhe etnike e shtresojnë vazhdimisht. Kjo kujtesë shndërrohet në nënshtresë të mbamendjes kolektive (si kujtesë kolektive) e në shtysë për ripërtëritje të saj (si vetëdije kolektive). Rrjedhimisht, ajo shndërrohet në arkistrukturë, ose themel mbi të cilin shtresohen shtresa ripërtëritëse, së cilave anëtarët e këtyre bashkësive u referohen vazhdimisht. Dëshira për ta ripërtërirë një strukturë të trashëguar nxit vazhdimisht një lloj narrative të popujve<sup>1</sup> për vetveten. Këngëtimi (epik) shndërrohet në mjet për pasqyrim të kujtesës kolektive e të ndjenjës së bashkësive për vetveten.

Kjo është pika thelbësore në të cilën studimet për letërsinë kryqëzohen me ato sociologjike, kulturore e historike. Ngase, narrativa e kombeve për vetveten (në arketipin e saj të hershëm) është letrare, artistike. Këngëtimi epik është mjeti që e bart këtë vetëdije dhe synon ta ripërtërijë atë, duke ndikuar madje edhe në vetë përforcimin e idesë së bashkësive për veten. A mund ta paramendojmë sot jetën në Arbërinë mesjetare pa këngëtimin epik, pa traditën popullore, e cila jo vetëm e ka mbajtur të gjallë kujtesën e përbashkët (etnike e kulturore), por i ka dhënë shtysë edhe ripërtëritjes së saj (duke e përforcuar karakterin etnik të arbërve)? Duke u shtresëzuar ato krijojnë lidhjen kohore mes historisë së popujve dhe vetëdijes së tyre për të kaluarën e përbashkët.

---

1. Bashkësive gjuhësore, kulturore, fetare ose etnike në periudhat pararomantike.

Kjo është edhe premisa e parë të cilën mban parasysh ky libër. Sepse, marrë në tërësi, letërsia ka pasur ndikim të pakundërshtueshëm në krijimin e identiteve gjuhësore, kulturore e etnike dhe përforcimin e ndjenjës së përbashkësisë. Në traditën shqiptare, shembulli i parë i dukshëm i ndërthurjes së pikëpamjeve kulturore me natyrën e letërsisë i përket mesjetës së vonshme, kur nëpërmjet botimit të librave e predikimit në gjuhën e vendit, *shkronja* (lettera) u bë mjet për mbajtjen gjallë të jetës kishtarë e, nëpërmjet saj, edhe të asaj kulturore.

Letërsia e romantizmit, ndërkaq, zhvilloi ndjenjën e fuqishme të përkatësisë kombëtare e, rrjedhimisht, ndikoi edhe në krijimin e të së parës lëvizje kombformuese, nëpërmjet krijimit të një vetëdijeje të re për jetën e kombeve në histori.

Prandaj, para se të shqyrtojmë raportin mes letërsisë si krijimtari artistike e pikëpamjeve të popujve mbi vetveten, duhet trajtuar natyra e kombeve (nga pikëvështrimi i prejardhjes së tyre historike). Për këtë synim, do të mbahen parasysh dy paradigmat e mëdha për prejardhjen e tyre: kultura e shtresëzuar si nënshtresë mbi të cilën formohen kombet, dhe zhvillimi industrialist e rrjedhoja e tij, legjitimimi politik i kombeve. Për t'i ballafaquar këto dy paradigma do të merret kushtimisht si i mirëqenë grupimi i kombeve në dy kategori të mëdha: kombe kulturore dhe kombe politike. Kjo do na japë mundësi më pas të shqyrtojmë edhe paradigmat kryesore për formimin e kombeve, të cilat përkojnë me këto dy kategori: etnosimbolizmin për kombet kulturore, ngaqë e përfill arkistrukturën kulturore si premisë për formimin e kombeve, dhe modernizmin për kombet politike, i cili kombin e sheh si rezultat të zhvillimit industrial (modern) dhe jo si strukturë të shtresuar.

## **Kombet kulturore dhe kombet politike**

Kujtesa e shtresuar dhe këngëtimi epik, sikur u theksua, u japin mundësi bashkësive kulturore që të krijojnë rrëfimtarinë (narrativën) për veten. Kjo rrëfimtari, e cila e përmbledh gjithë pikëshikimin historik mbi veten, shndërrohet në arkistrukturë, së cilës popujt i referohen. Mirëpo, ajo mbetet latente, “e padukshme” përjetësisht, nëse nuk



provohet që, nëpërmjet lëvizjeve kulturore, letrare e deri tek ato politike, të shndërrohet në shtysë për dëshmim.

Në jetën e kombeve (*jetën kombiare*, sikur e quante atë Anton Harapi), ka disa paradigma kulturore e historike, të cilat përbëjnë shtresën a nënshtresën mbi të cilën zë fill jeta e kombit. Këngëtimi epik i mban përjetësisht të gjalla, ndërsa synimi historik i shndërron në premisa për program politik. Historia e shqiptarëve njih dy momente kur trashëgimia kulturore është shndërruar në thelb të programeve politike, Lidhjen e Prizrenit (1878) dhe lëvizjen nacional-kulturore të viteve '90, të cilat në thelb kanë synuar themelimin e shtetit (shqiptar) si instrument politik, i cili ngrihet përmbi trashëgiminë kulturore (etnike e gjuhësore, po e po) shqiptare. Rezultati: krijimi i shtetit të Shqipërisë, më 1912, dhe atij të Kosovës, më 2008.

Por, ngaqë synim këtu është raporti me trashëgiminë dhe jo vetë karakteri politik i lëvizjeve nacionaliste, qofshin edhe të atyre nacional-kulturore, përqendrimi është te vetë natyra e kombeve. A është ajo (vetëm) kulturore, pra shtresim i trashëguar, të cilit (para)kombet, etnitë, i referohen si arkistrukturës së vet (ose hirit, nën të cilin rri e ndezur urna etnike), apo është shtresim i vazhdueshëm historik, të cilin lëvizjet nacionaliste e përlligjin si strukturë, e cila e legjitimon synimin e tyre për shtet? Apo, ndoshta, janë të dyja?

Përfundimi në të cilin synon të arrijë ky libër është ky: kombet janë rezultat i shtresimeve kulturore e historike (pra, janë kulturore si struktura të tejkohshme), por bëhen të mundura vetëm të nxitura nga zhvillimi i pikëpamjeve mbi vetveten (janë edhe kombe politike, duke qenë se përdorin shtetin si instrument që legjitimon vullnetin e tyre). Historia e kombeve-shtete ofron shembuj të “formimit” të tyre jashtë kësaj ndërlidhjeje, por vetëm në kuptimin e kërkimit të instrumentit për zbatimin e pikëpamjeve politike: shtetit-komb. Në anën tjetër, të përfillurit e pikëpamjeve kulturore e politike (natyra kulturore e politike e kombeve) e arsyeton edhe përcaktimin për të trajtuar letërsinë e hershme shqipe (para së gjithash atë filobibliiste e atë romantike) si krijimtari që u përgjigjen dy paradigmave për formimin e kombeve: asaj etnosimboliste dhe asaj moderniste. Por, çfarë është në thelb një komb kulturor dhe çfarë ai politik? Pse teoritë janë aq të ndara në

kategorizimin e tyre si “të ndryshme”, sikur ndryshueshmëria të mos qëndronte në thelbin e diskutimeve mbi natyrën e kombeve? Pra, a ka pikëtakime mes tyre? A mos ndoshta mu aty ku është menduar ndarja, pikërisht aty qëndron nyja që i përafuron ato drejt një kategorie të tretë: *kombet kulturëpolitike*? Shembujt e sipërpërmendur përbëjnë një fillesë.

Megjithatë, le ta shtyjmë për më vonë këtë hamendësim. Hëpërhë le të mjaftohemi me pohimin se ekzistenca e disa “pararendësve historikë” dhe kujtesa për ta krijojnë një paradigmë të fuqishme, sipas së cilës e kaluara duhet të ketë lënë të pashlyer vulën e saj. Prej këtej, është lehtësisht e kuptueshme se kombet përbrendësohen si strukturë politike mbi disa struktura të tejkohshme, të cilat në thelb janë kulturore. Prandaj, një nga synimet politike të përdorimit të kujtesës si mjet për ringjalljen e së shkuarës është vënia në pah e “së kaluarës së përbashkët”, tiparet e traditat (gjuhësore, fetare, kulturore a etnike qofshin), të dallueshme nga akëcili popull tjetër.

Shtysën e parë për konsolidimin e bashkësive të para e ka krijuar prirja për të dëshmuar ekzistencën e hershme dhe për ta bërë të dukshme dallueshmërinë. Në mesjetë kjo tendencë lidhej me ekzistencën e gjuhës e të riteve fetare. Kësisoj, u krijuan bashkësitë e para gjuhësore e u përbrendësua ideja e ritit liturgjik në gjuhën e vendit, duke bërë të mundur edhe përdallimin etnik (bashkësia që flet një gjuhë, ka një territor dhe ruan e kultivon ritet e njëjta). Bëmat epike dhe këngëtimi për to ia krijojnë kornizën historike përpjekjes për dallueshmëri, e cila është përforcuar vazhdimisht deri në krijimin e lëvizjeve (nacionaliste) në periudhën e romantizmit. Këto lëvizje synonin t’i bënin të dukshme vlerat e kombit e përdallueshmërinë nga të tjerët. Një nga mjetet më të fuqishme për ta bërë këtë është të shprehurit artistik, folklori (mbledhja e të cilit u shndërrua në synim jetësor të romantikëve) dhe epika letrare e historike, nëpërmjet rikrijimit e ridëshmimit (mitit të lashtësisë). Duke ringjallur të shkuarën e duke thurur mitin për të, romantikët krijojnë vetëdije të re, e cila të kaluarën e përbashkët, mitet, historitë dhe lashtësinë, kujtesën për to, synon t’i bëjë mjet për të dëshmuar ekzistencën e hershme të një “bërthame” të tejkohshme etnike dhe për ta jetësuar atë në institucion politik: në komb etnik.

Synimi i lëvizjeve nacionaliste, megjithatë, është i dyfishtë: krahas kërkesës për të dëshmuar lashtësinë historike të ekzistencës së strukturave etnike, ato synojnë edhe jetësimin e shtetit si mjet për ekzistencën e kombit.

Në gjykimin e tyre kombi ka ekzistuar shumë më herët (prej këtej beteja e tyre për të gjurmuar sa më thellë në lashtësi), prej nga ne kemi trashëguar këngëtimin për veten e kujtesën për bëmat epike (prej këtej pastaj përpjekjet për t'i ringjallur legjendat e mitet mbi lashtësinë e mbi heronjtë epikë), të cilat dëshmojnë për ndryshueshmërinë gjuhësore, zakonore, kulturore e përkatësore krahasuar me të tjerët (prej këtej përpjekja për të lartësuar gjuhën, traditat e zakonet), kujtimi i së cilave na ngjall dëshirën për ta “rikonsoliduar” atë në institucion politik (prej këtej, së fundi, lëvizjet kombëtare për shtet të pavarur).

Këngët epike shprehin thelbin e shpirtit të kombit, pjesën më të qenësishme dhe më të thellë të tij. Edhe kur janë krijuar vetëm në një pjesë të etnisë, ose në disa sosh, nën frymën e interpretimeve romantike e të pikëpamjeve nacionaliste ato marrin karakterin e veprave mbarëkombëtare. Ato përjetohen njësoj nga të gjithë anëtarët e bashkësisë etnike, të cilët pavarësisht se mund të mos i njohin plotësisht, i “shpallin” si të vetat. Eposi merr ngjyrë “etnike” nën dritën e programeve politike. Kësisoj, epika e hershme legjendare dhe ajo historike, cikli i këngëve kreshnike e deri tek epi kombëtar i Fishtës, kishin bërë jehonë në Malësinë e Mbishkodrës e në Kosovë, por dalëngadalë u shtrinë edhe në jug të Shqipërisë, deri në Çamëri, sepse shprehnin thelbin e asaj që anëtarët e këtyre trevave, të lidhur prej gjaku e gjuhe, e përjetojnë si kombin e tyre, ndërsa krijimtarinë letrare në gjuhën e tyre e përjetojnë si trashëgimi shpirtërore të vetën.

E njëjta gjë edhe për polifoninë, ose këngën “vënçe”. Ajo këndohet vetëm në një pjesë të Shqipërisë së Jugut, por në gjykimin tim ajo është e gjithë shqiptarëve, u takon atyre dhe përbën pasuri kombëtare të tyre. Kësisoj, gurra epike shndërrohet në formë përvetësimi dhe kalimi nga krahinorja te kombëtarja. Bashkësia që e ndien frymën e përbashkësisë nëpërmjet letërsisë, artit, përfiton një mënyrë të re të përfytyrimit të vetvetes përmes inxhinierimit kulturor dhe social. Letërisa epike i kërkon rrënjët në trashëgiminë e pasur shpirtërore, aq e nevojshme për

kombet etnike dhe kulturore, në të cilat kultura shpreh shpirtin e etnosit, e ankoron kombin në lashtësi, përpara daljes së letrës, në errësirën e kohëve të shkuara. Kjo, sikur merret me mend lehtësisht, është e tëra sajësë intelektuale, prandaj eposi dhe letërsia kthehen në mjet të fuqishëm për përfaqësimin e karakterit të vërtetë të bartësve të tyre, duke e kthyer vetë atë (eposin) në mjet për përforcim përkatësie etnike.

Por, a mund të thuhet ende se lëvizjet nacionaliste e kanë konsoliduar ekzistencën e kombeve? Për më tepër, a mund të hamendësojmë që tani se letërsia, para së gjithash ajo popullore, ka qenë “shtrati” mbi të cilin është bartur vetëdija për kombformimin e kombkonsolidimin? Duket pretendim tepër i lartë për ta pranuar qysh tani, sado që mundësia e kundërshtimit duket e pagjasë.

Duket sikur kombet *këngëtojnë* e *kujtojnë* dhe duke kujtuar vetëdijësohen për ekzistencën e tyre në histori. Këngëtimi është ndërloja që popujt zhvillojnë me veten në harkun e historisë dhe sojesh krijojnë fijen që i mban të lidhur për rrënjën e vet, të rigjetur në histori, të krijuar në kulturë ose të thurur në mit. Poetët, qofshin ata rapsodë popullore ose autorë tekstesh të shkruara, paraqesin synime të vazhdueshme për të “përjetësuar” qëllimin historik në “këngë”, pra në krijime letrare. Këngët legjendare dhe ato historike, të bartura gojë më gojë nga brezi në brez marrin përsipër rrëfimin për vetveten, një detyrë e padashur për to, nëse u referohemi kanoneve të letërsisë, por e pashmangshme pothuajse në të gjitha traditat letrare. Ato mbajnë të gjallë frymën dhe karakterin e popujve, duke e ripërtërirë atë në diskurs të afërt me rrëfimitarinë popullore. Duke e ripërtërirë atë ato ripërtërijnë kujtesën kolektive mbi heronjtë dhe karakterin heroik të popullit të tyre. E, sikur dëshmon libri, ringjallja e kujtesës nëpërmjet miteve të ripërtëritshme është njëra nga premiset të cilat i shërbejnë krijimit ose përforcimit të idesë për jetën e përbashkët.

Bashkësitë etnike i janë mirënjohëse letërsisë për këtë “dhuratë”. Por, vetë letërsia, në anën tjetër, e gjen burimin e frymëzimit në vlerat e përbashkëta të bashkësive (etnike e kulturore). Kësisoj nis të ndërtohet një traditë letrare e frymës “së vendit”.

Por, a mund të lidhet shkrimi letrar edhe me përkatësinë jashtëletrare, përkatësisht me kategoritë kulturore e politike, siç janë *gjuha* dhe

*kombi? A mund ta cilësojmë, ta zëmë, gjuhën si shenjë të përkatësisë së letërsisë?*

Nëse sikur thuhet “gjuha është shenja dalluese e një kombi”, parimi se duhet të flasim për një përkatësi kulturore e politike në letërsi përligjet. Por, kjo mbase e relativizon funksionin e saj, ngase të shkruarit në një gjuhë e tkurr në relacion mes kulturës e politikës. Të jetë kjo arsyeja pse gjuha është jo rrallë e pashkëputshme nga ideologjia? Nëse sot flasim për *letërsi shqipe*, a nënkuptojmë me të përkatësi letrare, kulturore apo kulturore-politike? Argument i parë dhe lehtësisht i kuptueshëm për këtë mbeten filllet e të shkruarit letrar në gjuhën shqipe. Çfarë e dallon, ta zëmë, letërsinë e Buzukut, Budit e Bogdanit, deri edhe të Varibobës, nga letërsia e kohës, nëse jo gjuha? A do të ishin ata autorë të letërsisë shqipe nëse do të vazhdonin të shkruanin në latinishten vulgare, ta zëmë, pavarësisht prejardhjes së tyre etnike?

Meqë për ta gjuha shënjon përkatësi, sot ata i shohim si autorë të *letërsisë shqipe* (të shkruar në gjuhën shqipe). Kjo, megjithatë, nuk është ende shenjë dalluese (çfarësuese) e përkatësisë së letërsisë së tyre. Gjuha arkaike e tyre është mjeti të cilin e zotërojnë, por edhe kultura të cilën e bartin. Kësisoj, ata shkruajnë tekste në gjuhën shqipe, duke ndjekur fillin e një letërsie të re, letërsisë së shkruar në gjuhën shqipe.

Pra, mes letërsisë dhe zhvillimit historik të kombeve ekziston një proces i përhershëm marrjeje-dhënieje, i cili i mban të lidhura përhershëmrisht me njëra-tjetrën. Kjo lidhje shndërrohet në shtysë të përhershme motivimi. Kësisoj, bashkësitë kulturore e gjuhësore, fetare e etnike krijojnë narrativën e vet në letërsi, ndërsa letërsia, duke bartur peshën e historisë e të përfytyrimit të tyre për veten, lidhet pashmangshëm për kërthizën e përbashkët me anëtarët e tyre. Ajo bart ndjenjat e tyre, derisa edhe vetë shndërrohet në platformë frymëzuese për ta.

Letërsia, sikur dihet, i paraqet ngjarjet *si të ndodhshme*, në një diskurs i cili synon estetikën. Por, jo rrallë, këto të ndodhura paraqesin kujtesën kolektive mbi ngjarje historike dhe këtu historia e letërsia pikëpreken për të mos u shqitur më. Homeri e krijoi modelin e parë të rrëfimit të historisë sipas përmasës së diskursit letrar. Në letrat shqipe Barleti e krijoi modelin e “historisë” së kujtuar “nga ata që kishin marrë pjesë”

ose që i kishin parë me sytë e tyre betejat e Skënderbeut, ose kishin marrë pjesë në to, sikur i ngjet vetë atij kur si “një spektator jo i huaj”<sup>1</sup> e sheh rënien në duart e osmanëve të së fundmes kala shqiptare, asaj të Shkodrës.

Nga letërsia antike tek ajo e romantizmit krijimtaria popullore kishte krijuar “Homerë të shumtë të njëkohshëm”,<sup>2</sup> të cilët duke e tejshkuar historinë i gjejnë pasqyrat e kombit,<sup>3</sup> së cilave ua largojnë pluhurin. Këto pasqyra historike shpluhurosen vetëm në pasqyra të të rrëfyerit, në këngë. Ato bartin madhësitinë “historike”, bëmat epike. Kjo është arsyeja mbase pse letërsia antike, por edhe ajo e mesjetës mbështeteshin në modele heroike. Ato kërkonin heronjtë dhe u këndonin bëmave të tyre.

Jeronim de Rada,<sup>4</sup> nismëtar e artikulues i vetëdijes romantike shqiptare, nënvizonte lidhjen e fuqishme mes këngës (krijimit popullor shqiptar) dhe realitetit historik, duke i parë ato si rrjedhojë të përpjekjes për mbamendje kolektive dhe për artikulum të saj si premisë mbi të cilën mund të zhvillohej arti, kultura e letërsia:

*(Kangët popullore shqiptare)... janë krejt afër realitetit historik, sa që i mbetet pak vend artit dhe ndikesës së tij.*<sup>5</sup>

Bëmat heroike përtëriten në një strukturë të ripërtëritshme mitesh e këngësh, në korpusin e traditës gojore epike ose në *kartë*. Kësisoj, brezat e rinjohin historinë epike të paraadhësve të tyre dhe e ripërtërijnë mitin mbi bëmat e heronjve, duke ia veshur përvojës së mëhershme

---

1. *Domesticus veteris fortunae spectator*. Marino Barlezio, prefazione, I.v, VI, 66, IX, 113, 118; XI, 134 ecc. Cituar sipas: Francesco Pall, *Marino Barlezio, Uno storico umanista* (Cluj, Rumani, 1938), Biblioteca Apostolica Vaticana, Racc. Gen. Vite, IV 3518, fq. 2.

2. Prej këtej emërtimi “traditë homerike” për një tip letërsie të zhvilluar si “letërsi e së shkuarës”, pra letërsinë që mbështetet në të dhënat historike dhe zhvillon madhësitinë epike.

3. Thiesse, *Krijimi i identiteteve kombëtare...*, e cit., fq. 136.

4. Për idetë romantike të De Radës dhe letërsinë e tij të frymës nacionale shih librin e tretë: *Romantikët e pasromantikët*.

5. Jeronim de Rada, Parime të estetikës (Kangët popullore shqiptare), në: *Vepra letrare 3* (“Naim Frashëri”, Tiranë, 1987), fq. 181.

këngëtimin e tyre. Betejat rikthehen si histori e si mit, ato ripërtërihen, ringjallen, rishtresohen.

*Betejat e zhvilluara më herët në histori, marrin peshë sërish.<sup>1</sup>*

Duke e bartur *ndë'kartë* këtë trashëgimi historike të kombeve, letërsia u ndihmon atyre që të dëshmojnë praninë e tyre historike dhe t'i përforcojnë shenjat përkatësose të tyre. Edhe nëse këto struktura janë bashkësi të diferencuara kulturore, religjioze a etnike, ato provojnë ta bëjnë të dukshme jo vetëm praninë e tyre historike, por edhe përkatësinë e tyre të veçantë. Letërsia i shërben këtij synimi të kombeve.

Në diskutimet për (mbi)jetesën e kombeve, ka ekzistuar tradicionalisht një lloj besimi se kultura e përbashkët, e theksuar nëpërmjet letërsisë dhe arteve, i shndërron *bashkësitë historike* në “bashkësi tejhistorike”, të cilat narrativa letrare i paraqet si të përjetshme, duke i ndërlidhur ato me lashtësinë dhe duke u dhënëtribute të cilat vetë historia nuk mund t'i dëshmojë.

Sipas kësaj narrative, këto bashkësi prej kohësh jetojnë në një territor të caktuar, zhvillojnë të njëjtat prirje, kanë rite e zakone të përbashkëta dhe i lidh bashkë gjaku e gjuha. Në pikëshikimin e epikës gojore, sidomos, këtyre bashkësive zotat u kanë falur cilësi të larta dhe ua kanë dhuruar eternitetin (tejkohësinë), ndryshe nga bashkësitë “e përkohshme”, të cilat shfaqen dhe zhduken në çaste të caktuara.<sup>2</sup>

Por, le të kthehemi edhe një herë te pyetja fillestare: A e ka ndihmuar më shumë letërsia zhvillimin e kombeve, apo kombet, të krijuara njëherë, e kanë nxitur krijimin e një letërsie të farës nacionale, e cila provon “t'i zbulojë” veçantitë e tij dhe t'ia bartë ato lexuesit “të pamësuar”? Sikur u theksua tashmë, krijimi i kombeve kulturore e njeh rolin e narrativës

---

1. David Miller, *Mbi kombësinë*, përktheu: Greta Avdyli (“Cuneus”, Prishtinë, 2022), fq. 15.

2. Duke përdorur nocionin “bashkësi tejhistorike” po pranojmë pjesërisht pohimin se ritheksimi i transcencave bart një lloj imagjinariteti për vetveten e për rolin e tij në histori. Porse, kjo nuk nënkupton që kombet janë vetëm produkt imagjinar, sikur pretendonte Benedikt Andersoni. Shih: B. Anderson, *Komunitete imagjinare - Reflektim mbi origjinën dhe përhapjen e nacionalizmit* (“Dy Lindje & Dy Perëndime”, Tiranë, 2013).

epike për ekzistencën e hershme të tyre, sikurse zhvillimi i letërsisë (së paku i një fare të saj, asaj kombëtare, dhe i një forme të saj, gojore) është i pashkëputur nga ndjenja për vetveten. Ajo buron e zhvillohet në truallin e kombit e në mbamendjen e tij. Kjo ndërlidhje është e përhershme dhe e pandashme nga perceptimi i kombeve për vetveten. Ky pohim, megjithatë, nuk e zgjidh përfundimisht problemin. Ngase, letërsisë mund t'i njihet ky rol vetëm nëse pranohen si paradigma të qëndrueshme teoritë që e përqafojnë konceptin e kombeve të krijuara thellë në histori (kombet tejhistorike),<sup>1</sup> që nuk marrin nënshtresa gjatë zhvillimit të tyre dhe nuk janë objekt i ndryshimit historik. Konceptet mbi kombet kulturore i përafrohen këtij koncepti për aq sa shtresimet kulturore primordiale përbëjnë shtresë etnokulturore, mbi të cilën shtresohet kultura etnike, por e tejkalojnë atë ngaqë janë historike, pra mbishtresohen, duke vendosur shtresa të tjera etnokulturore. E, megjithatë, shërbejnë si paradigmë e qëndrueshme, mbi të cilën krijohet vetëdija (politike) mbi veten.

Nga ky pikëvështrim, nuk mund të themi se shtresimet kulturore vetvetiu mund ta krijojnë kombin, sikurse nuk mund të themi se krijimi i vetëdijes politike për një bashkësi (bashkësi kulturash të ndryshme) mund të identifikohet domosdo me kombin e ri (e shumta, mund ta përdorë instrumentin politik, shtetin, për t'u njëjtësuar me të, por në atë rast flasim për shtet-komb dhe jo për komb, si shtresim historik vlerash). Kosova, shtet i themeluar pas shpërbërjes së Jugosllavisë, por me një shtresim të dukshëm kulturor e etnik shqiptar, mund të ishte shembull i krijesave të quajtura shtete-kombe, por kjo nuk do ta ndryshonte karakterin e saj etnik dhe shtresimet e saj kulturore.

Sido që të jetë, pikëshikimi për kombet tejhistorike mund të kundërshtohet edhe nga teoritë, të cilat zhvillimin e kombit nuk e shohin të lidhur për shenjash etnohistorike, por për veprime nacionaliste,<sup>2</sup> sipas

- 
1. Koncepti i tejhistorikes ndërlidhet me cilësi të pandryshueshme gjatë historisë njerëzore, që nuk i referohen zhvillimit të shoqërisë në një moment të caktuar historik, por e përcaktojnë rrjedhën e saj, si paradigmë e përhershme.
  2. Sipas Ernest Gellner-it "nacionalizmi ka ndikuar në krijimin e kombit aty ku ai nuk ka ekzistuar më parë". Shih: Ernest Gellner, *Culture, Identity and Politics* (Cambridge University Press, Great Britain, 1987); Sipas etnosimbolistëve, ►



së cilave kombet mund të lindin edhe aty ku ato nuk kanë ekzistuar më herët. Këto janë *kombet politike*, zhvillimi i të cilave ndërlidhet me zhvillimin industrial dhe me lëvizjet e ndryshme politike, më shumë sesa me trashëgiminë e përbashkët.

Atëherë, si krijohen kombet? Ç'atribute mund t'i jepet të shprehurit letrar për krijimin e tyre? A nuk duket pretendim i tepruar përpjekja për ta ndërlidhur krijimin e kombeve, zanafillën e tyre, me zhvillimin e letërsisë? Tekefundit, a mund të jetë letërsia artikuluese e çfarëdoshme e ndjenjës historike të kombeve? Pikërisht prej këtej rrjedh edhe synimi për t'i trajtuar ato në raport me njëra-tjetrën e pashkëputshëm njëra-tjetrës. Ngase, në krijimin e kombeve nuk luan rol vetëm qëndrimi politik mbi “përkatësinë” në një çast të caktuar historie dhe format e shprehjes së saj,<sup>1</sup> por edhe tërësia e vlerave të krijuara e të ruajtura gjatë historisë.<sup>2</sup> Sipas pikëvështrimit tim, së paku në Europën Juglindore kombet janë krijuar mbi një bërthamë etnike, e cila u ka qëndruar sprovave historike dhe është homogjenizuar vazhdimisht, derisa, në kapërcyell të shekujve XVIII e XIX e ka formuar edhe vetëdijen për shtetin si instrument politik për jetësimin e kombit. Bërthama mbi të cilën janë krijuar ato përbën *strukturë të tejkohshme*, e cila trajtohet si para-komb (proto-komb), ngase bart historikisht kulturën e trashëguar dhe traditën e përbashkët.

Ky zhvillim historik nuk përkon, megjithatë, me krijimin e kombeve të tjera, para së gjithash kombit amerikan, prandaj përpjekja për të dhënë pasqyrë mbi krijimin e kombeve gjithandej rruzullimit<sup>3</sup> mund të kundërshtohet lehtësisht. Sido që të jetë, ajo qëndron si paradigmë për krijimin e kombeve në Gadishullin Ilirik.

---

◀ ndërkaq, kombi është “bashkësi e vetëpërcaktuar, anëtarët e së cilës kultivojnë simbolet, mitet, kujtesën, vlerat dhe traditat, jetojnë brenda një territori e një *homeland*-i, krijojnë dhe shpërndajnë kulturë publike, si dhe i respektojnë zakonet e përbashkëta dhe ligjet standarde”. Shih: A. D. Smith, *Ethno-Symbolism and Nationalism, e cit.*, fq. 23.

1. Ky pikëvështrim paraqet themelin e teorive mbi krijimin e kombeve të ashtuquajtura politike.
2. Kombet kulturore janë krijuar mbi një strukturë mitesh, kujtese e traditash.
3. Nacion i Gjergj Fishtës për “botën”.

Por, le të kthehemi te raporti që letërsia krijon me këto struktura të tejkohshme dhe të shohim se si ajo e ka ndjekur e frymëzuar këtë kapërcim nga “krijimi i jehonës” për të kaluarën e lavdishme te përprjekja për institucionalizim të vetëdijes kombëtare. Kombet provuan që nëpërmjet tyre “ta zbardhnin” të kaluarën shpirtërore të tyre. Duke i kërkuar paraardhësit e vet edhe aty ku historikisht nuk mund të ekzistonin, ose duke i ringjallur traditat e tyre në “këngë” epike, nëpërmjet kërkimit të “relikteve të fshehura të trashëgimisë së etërve”,<sup>1</sup> kombet dëshmuuan se nuk janë rrjedhojë vetëm e përcaktimit politik mbi përbashkësinë, por ruajnë diçka të brendshme, e cila mund të shpjegohet vetëm nëpërmjet tejkohshmërisht mitike.

Megjithatë, a mund të themi se trashëgimia kulturore e etnike, gjuha, ritet, zakonet dhe mitologjia e pasur janë shenjat e vetme për përcaktim përkatësie kombëtare? A do të mund t’u bënin ballë zhvillimeve të fuqishme historike nëse në përpjekjen e tyre për krijim e ruajtje përkatësish të mos mbështeteshin edhe në vendimmarrjen politike?

Institucionet politike ndikojnë në përforcimin e idesë së kombit, ngase disa sjellje të tyre nuk janë të trashëguara. Ato “janë shpikur gjatë historisë”, ndërsa autorësia e tyre u përket kryesisht regjimeve të ndryshme politike.<sup>2</sup>

Nëse bërthama e kombeve është e trashëguar, nevoja për të jetuar krahas kombeve të tjera e në pikëprekje të vazhdueshme me to, herë fërkuese e herë paqetuese, e bën të pashmangshëm perceptimin për vetveten mbi përvojën dhe vendimmarrjen politike.

Ngaqë synimi ynë, megjithatë, është ta shohim raportin e letrave dhe të arteve me përkatësinë kombëtare dhe jo vetë historinë ose format e formimit të përkatësive kombëtare, le ta trajtojmë natyrën e letërsisë në

- 
1. Anne-Marie Thiesse, *Krijimi i identiteteve kombëtare*, vep e cit., fq. 23. Ajo përmend edhe emërtime të tjera për këtë marrëdhënie, sikur janë, ta zëmë, “reliktet e fshehura të trashëgimisë së etërve”, ose “akademia e kulturës fillestare” dhe “kërkimi i gralit kombëtar”, me të cilat synon të trajtojë këtë ndërvarshmëri mes letërsisë e krijimit të kombeve.
  2. Diskutimi i derikëtushëm, përgjithësisht, përkon me teoritë kryesore mbi natyrën e formimit të kombeve dhe mbi karakterin e tyre historik, sipas të cilave ekzistojnë *kombet kulturore* (bërthama e të cilave shtrihet në kulturën e përbashkët) dhe *kombet politike* (të cilat janë prodhim i institucioneve politike).

raport me këto “relikte të fshehura” të së shkuarës, si dhe rolin e tyre në natyrën e letërsisë.

Në rast se do ta zhvishnim përkatësinë kombëtare nga pesha etno-historike, roli i letërsisë në krijimin e përkatësive (duke përfshirë edhe atë kombëtare) do të relativizohej në një lloj marrëdhënieje të padenjë për solidaritetin e përgjithshëm mes përfaqësuesve të një kombi. *Besnikëria* dhe *devotshmëria*, parime të *etnosimbolizmit historik*, do të shkriheshin në elemente ndërvepruese ose ndërrefuzuese, varësisht nga synimet e kombit dhe të letërsisë, të cilat jo rrallë janë në shpërputhje me njëra-tjetrën (ngase “kanonet” mbi të cilat ata veprojnë jo rrallë janë të papërputhshme).

## ***Etnosimbolizmi***

Etnosimbolizmi, njëra ndër katër paradigmat kryesore për formimin e kombeve (krahas perenializmit, modernizmit dhe primordializmit), e trajton formimin e kombeve përmbi disa simbole etnike (etnosimbole), të përbashkëta për të gjithë anëtarët e një bashkësie. Këto simbole janë: gjuha,<sup>1</sup> traditat e kultura e përbashkët, mitet e kujtesa, madje edhe ndjenja për të përbashkëtën. Ajo i trajton rrënjët etnike si premisë për formimin e kombit modern.

Pikëvështrimi mbi simbolet etnike si struktura të tejkohshme e përafrojnë atë me primordializmin,<sup>2</sup> të cilët kombin e shihnin si strukturë të ardhur nga lashtësia e shekujve në formën që paraqiteshin në një

- 
1. Duhet vërejtur, megjithatë, se jo çdo herë gjuha e përbashkët (ose e përafërt) ka rezultuar me formimin e kombit (gjuhësor). Afërsia gjuhësore mes kroatëve, serbëve, malazezëve etj., nuk ka krijuar kombin sllav në Europën Juglindore (Gadishullin Ilirik). Madje, as projekti politik për t'i bërë bashkë sllavët e jugut në Jugo/sllavi, nuk rezultoi me shkrimje kombëtare brenda sajësës politike. Të mos flasim pastaj për përjashtimin që shqiptarët, vojvodinasit e deri diku edhe maqedonasit paraqitnin në këtë përpjekje. Pra, gjuha është (vetëm) njëri ndër simbolet etnike, e cila bëhet vepruese vetëm nëse është *ndërvepruese* me elemente të tjera etnike: trashëgiminë, ritet, traditat e zakonet, kulturën e përbashkët dhe, së fundi, vetëdijen mbi veten e “tjetrin”.
  2. Të shihet pjesa: Primordialistët, në këtë libër.

moment historik. Etnosimbolistët e pranonin se struktura e tejkohshme e kombit (bërthama etnike) ishte themeli mbi të cilin vetëdija për veten (lëvizjet nacionaliste) ndikonin në artikulumin e kësaj vetëdije dhe, rrjedhimisht, në kompaktësimin e strukturës etnike në struktura (mbi) etnike: kombet. Njëri ndër përfaqësuesit kryesorë,<sup>1</sup> John A. Armstrong, ia njihte nacionalizmit fuqinë që përmbi “thesarin” etnik, të grumbulluar ndër shekuj dhe identifikimin e plotë me të të anëtarëve të bashkësive etnike, ta artikulonte kërkesën për organizim të mirëfilltë politik:

*Nacionalizmi paraqet fazën e fundit të ndërgjegjes etnike, e cila zbret deri në format më të hershme të organizimit kolektiv.*<sup>2</sup>

Ky vlerësim, të cilin e përfill gjithë libri, nuk nënkupton se qëndrimi i Armstrongut dhe i etnosimbolistëve të tjerë përafrohet me atë të modernistëve, sipas të cilëve kombet kanë lindur si rezultat i shpikjeve industrialiste dhe përfuturit të një vetëdijeje moderne për veten. Madje, etnosimbolizmi ka lindur pikërisht si kundërpeshë e teorive moderniste.<sup>3</sup> Ndryshe nga to, etnosimbolizmi mbështetet në përvojën kulturore të popujve, e cila, e shtrirë në sfond afatgjatë historik, shndërrohet në bërthamë mbi të cilën homogjenizohet kultura e përbashkët, si bërthamë primordiale e krijimit të kombeve. Kultura e trashëguar, e bartur brez pas brezi në formë kujtese, e nxit përforcimin e idesë për kulturën përkatësore, e cila duke u përforcuar shndërrohet në përkatësi kulturore e etnokulturore.

Për etnosimbolistët, kombet e zhvillojnë *kujtesën* për vetveten, para së gjithash për kohët e arta, të cilat përkohjnë me bëmat epike të heronjve. Kësisoj, kujtesa shndërrohet në premisën e parë të rëndësishme për ekzistencën e kombeve. Ajo dëshmon për ekzistencën e një kulture të lashtë dhe të një populli heroik, bëmat e të cilit janë të njohura

---

1. Pas Anthony D. Smith-it, të cilin do ta trajtojmë gjerësisht në këtë pjesë.

2. Özkirimli, Umut (2010). *Theories of Nationalism: A Critical Introduction* (2nd ed.). London: Palgrave Macmillan. p. 145.

3. Anthony D. Smith ishte nxënës i njërit prej përfaqësuesve më të denjë të teorive moderniste, Ernest Gellnerit dhe kishte marrë pjesë në debatet e organizuara nga ai mbi kombin e nacionalizmin në London School of Economics.

historikisht. Kësisoj, lind premisa e dytë e rëndësishme, *miti*, ekzistenca e të cilit është e pashmangshme jo vetëm për të dëshmuar lashtësinë e ekzistencës së kombit, por edhe origjinën e etnisë/kombit.<sup>1</sup> Së bashku, mitet dhe kujtesa e mbajnë të gjallë *frymën*, shenjën identifikuese me të cilën kombet shpalosen para të tjerëve dhe dëshmohen historikisht (së paku në pasqyrimin që atyre ua bën letërsia).

Letërsia e vjetër shqipe, sikur do të shihet, është e lidhur ngushtë me shenjën e dëshmimit: të dëshmimit të ekzistencës së një populli të veçantë, i cili jeton në një territor të caktuar, ka kulturë e traditë të veçantë dhe kultivon shenjat e veta përdalluese, *gjuhën, gjakun, kulturën e territorin*.

Secila nga shenjat dalluese të tij nxit kultivimin e narrativës së tij mbi vetveten. Gjuha, tipari i parë identifikues në jetën e kombeve, është objekti i përhershëm i teksteve letrare, por edhe i synimeve të epokave kulturore. Letërsia e vjetër shqipe u krijua si përpjekje për ta bërë të dallueshme grigjën e për t'i shërbyer asaj duke e ngritur kultin e gjuhës. Duke përkthyer në gjuhën shqipe ose duke shkruar në këtë gjuhë autorët e vjetër provonin ta afronin popullin më afër kishës, më afër vetes. Romantikët nacionalistë, ndryshe nga ata shekullarë, të cilët shpërfillnin të veçantën, lokalen, autentiken, në emër të një mesazhi mbarënjëzësor, e shndërruan gjuhën në tiparin dallues përkatësor dhe i njohën asaj ndikimin e jashtëzakonshëm për formimin e kombeve. Sipas tyre, njerëzit e një *gjaku*, të cilët i bashkon gjuha, përbëjnë *grup homogjen*. Ata i nënshtrohen një lloj procesi të vazhdueshëm të “gërmimit në vetvete”,<sup>2</sup> i cili lidhjen farefisnore ose bashkësinë e njerëzve që besojnë në disa vlera të përbashkëta provon t’ia nënshtrojë procesit të njëjtësisimit të vazhdueshëm në kategori të diferencuar politike: kombin.

- 
1. Këtu koncepti i përafrohet atij të Anthony D. Smith-it mbi paradigmat etno-simboliste të formimit të kombeve dhe rolit që mitet dhe kujtesa luajnë në formimin e tyre. Shih: A. D. Smith, *Myths and Memories of the Nation* (New York, Oxford University Press, 1999), kaptina e parë, fq. 3-55.
  2. Ky nocion shpreh koncept të përafërt me atë të Ph. Schwyzer-it për “soditjen e vetvetes” (ang: contemplation in itself). Shih: Philip Schwyzer, *Literature, Nationalism and Memory* (Cambridge University Press, UK, 2004), fq. 49.

Nga sa u tha më sipër lind pashmangshëm hamendësimi nëse gjuha<sup>1</sup> qenkësh *shenjë e parë përkatësore* e një letërsie, si dhe nëse ajo e ka përcaktuar karakterin e të gjitha lëvizjeve kulturore në mesjetë? A mund të ndikojë ajo në përkufizimin pa tepri të *një* letërsie, e cila e përdor atë, dhe a është kjo veçanti shprehje e trashëgimisë gjuhësore? Nëse e pranojmë për të mirëqenë parimin herderian se “në gjeninë e gjuhës ndodhet shpirti i kombit”, lidhja mes shenjës së gjuhës e shenjës së kombit bëhet e përhershme.<sup>2</sup>

Thelbësor, megjithatë, mbetet hamendësimi nëse gjuha e ndihmon krijimin e përkatësisë kombëtare, apo është vetëm mjet shprehës i saj. A është letërsia që krijohet në gjuhën angleze, letërsi britanike, angleze, skoceze, uellsiane, apo është përafrim “letërsish” e kulturash nën perandorinë dominuese të gjuhës? Po kështu, mund të hamendësojmë sot për letërsinë që krijohet në Shqipëri, në Kosovë ose ndër shqiptarët që jetojnë në mërgim. Por, ky pikëshikim “bashkëkohor” për zhvillimin e letërsisë, nuk mund t’i atribuohet zhvillimit historik të saj. Në romanizëm, letërsia shqipe - për shkak të rrethanave historike - zhvillohej kryesisht në qendra kulturore jashtë Shqipërisë dhe Kosovës së sotme e megjithatë ishte letërsi shqipe. Atë e bënte të tillë përkatësia dhe funksioni.

Veçse, a mund të jetë përkatësia sociale, etnike e kulturore përcaktuese e letërsive përkatësore, së cilave gjuha u shërben si mjet? A është kombi “objekt suprem i besnikërisë sonë”,<sup>3</sup> apo ai relativizohet nën tendencën moderne të bashkëjetesës së kombeve në struktura mbinacionale (sikurse është Bashkimi Europian, ta zëmë)? Rrjedhimisht, a është gjuha shenja përkatësore e të gjitha bashkësive që mund të jetojnë administrativisht

---

1. Për raportin që gjuha ka me etninë dhe për pasqyrimin e raportit të letërsisë si fushë e cila e përdor gjuhën si mjet dhe objektit të saj, shih edhe: Rexhep Ismajli, *Gjuhë dhe etni* (“Rilindja”, Prishtinë, 1991).

2. Për këtë epokë shkrimesh, “gjuha, poezia dhe populli nuk përbëjnë veçse një tërësi”. Shih: A. M. Thiesse, *Krijimi i identiteteve kombëtare*, vep. e cit., fq. 45. Po kështu, gjuha shihet si faktor “bërthamë” në krijimin dhe ekzistimin e kombeve. Rrjedhimisht, roli i saj përbashkues është i jashtëzakonshëm, krahas shenjave të tjera, sikur janë territori, miti, simbolet e kujtesa e përbashkët.

3. D. Miller, *Mbi kombësinë*, i cit., fq. 17.

në të njëjtin shtet, apo është shprehje e veçantisë gjuhësore të secilës prej bashkësive që jetojnë në të?

Ekzistenca e gjuhës (e një gjuhe) është shenjë e ekzistencës së besimit në ndjenjën e përbashkët. Sikurse besimi, etnologjia e arkitektura, të cilat mund të jenë të ndryshme nga një zonë në tjetrën, edhe gjuha mund të shfaqet në më shumë dialekte a ideolekte, por kjo nuk përbën “aftësi” ndarëse, por përbashkuese.

*Duhet thënë se ndryshimet e dukshme në dialekt dhe në besim nuk e përjashtojnë ndjenjën etnike të komunitetit.<sup>1</sup>*

Kësisoj, gjuha shndërrohet në mjet të fuqishëm për krijimin e besimit në përkatësi. Nëpërmjet krijimit dhe ruajtjes së kujtesës së përbashkët, ajo ndikon në krijimin e një morali etnik, krahas synimit përbashkues. Ky lloj morali, i ngritur në kanun, pra në normë të pakapërcyeshme morale e juridike, shndërrohet në element dallues nga etnitë e tjera. Kësisoj, gjuha ndikon në krijimin e një ndjenje të veçantë, të cilën Veberi e shihte si “nder etnik”.<sup>2</sup>

*Nderi “etnik” është një nder i veçantë i masave, pasi ai është nderi i kujtudo, që i përket komunitetit të përbashkët të origjinës, të menduar në mënyrë subjektive.<sup>3</sup>*

Teoritë bashkëkohore (Anne Holden Rønning) theksojnë se letërsia e krijuar në një gjuhë të veçantë është mjet për forcim përkatësisish. Ajo ndikon në formimin ose përforcimin e *përkatësisë sociale*, por ka rol të theksuar edhe në krijimin e përkatësisë kombëtare. Nocioni *letërsi shqipe* është përcaktimi për letërsinë e zhvilluar përmbi një gjuhë: atë shqipe. Kjo letërsi zhvillohet në një kontekst të caktuar social e kulturor dhe i bart së brendshmi shenjat e tij. Pra, sa herë flasim për letërsinë shqipe nënkuptojmë edhe format dhe funksionet e veçanta të

---

1. Max Weber, *Studies in sociology*. e cit., fq. 132.

2. Nderin etnik, si dhe funksionet e tij në përbashkimin etnik, e kam trajtuar edhe në pjesën për kujtesën historike. M. Weber, *Studime sociologjike*, vep. e cit., fq. 132.

3. Po aty, fq. 132.

saj, krahas kontekstit. Këto kategori janë *kategori përkatësore*, prandaj do t'i trajtojmë veçmas, edhe për të hetuar se si kanë ndikuar format kryesore të letërsisë në krijimin e karakterit përkatësor të saj. Letërsia, sidomos ajo popullore, e ka përcjellë këtë rrugëtim si një bashkudhëtare e përhershme dhe e kujdesshme ndaj ndjenjës së etnive dhe brengave të tyre.

Letërsia e hershme shqipe përbën shembull paradoksal të këtij rrugëtimi. Ajo nuk shpalos shpirtin e etnisë në tematikë dhe ide, pra nuk mëton që të përforcojë ndjenjat etnike të shqiptarëve. Mirëpo, duke qenë se mbetet thellësisht e lidhur për farën biblike, ajo përforcon lidhjen kulturore të tyre, duke i homogjenizuar arbërorët rreth idealit të gjuhës e të kulturës së përbashkët. Autorët e saj i shërbenin një kulture, asaj shqiptare, dhe kultivonin një gjuhë, atë shqipe. Kësisoj, ata përforconin pahetueshëm vetëdijen për kulturën e përbashkët arbërore dhe provonin t'i theksonin veçantitë e saj. Në karakterin e kësaj letërsie, nacionalja dhe nacionalizmi ishin të pahetueshme, mund t'i gjeje të shkruara në një përpjekje për vetëdëshmim e homogjenizim, pa synime nacionaliste. Por, kjo ka mjaftuar që idetë romantike kombëtare të gjenin tashmë nënshtresën mbi të cilën do të krijonin platformën për kombin: gjuhën, kujtesën e traditën e mëhershme historike e kulturore, e para e dëshmuar në veprat e autorëve humanistë, e dyta të atyre filobibliistë. Ata, sikur thoshte Smithi, e kishin farkëtuar kulturën kombëtare dhe përkatësinë politike. Përkatësia kulturore është tejkohshme, e tejbartur historikisht. Rrjedhimisht, kombet (kulturore) duhet të shihen si produkt i një vetidentifikimi të vazhdueshëm “kulturor-historik”, të cilin njerëzit e kultivojnë dhe e ndajnë me njëri-tjetrin. Ata kultivojnë ndjenjën për vetveten dhe provojnë ta ripërtërijnë vazhdimisht atë, duke i shtesuar historikisht premisat mbi të cilat varin ekzistencën e vet. Kjo ka ndikuar që krijimtaria e tyre (popullore, para së gjithash) të jetë shumë e pasur. Këngëtimi epik-legjendar, mitet e pafund për heronjtë mesjetarë dhe kujtesa mbi bëmat epike, u shndërrua në mjet të fuqishëm për shpalosje të vlerave të përbashkëta e forcim të tyre nëpërmjet këngëtimimit e kujtimit. Shqiptarët, ngjashëm me popujt e tjerë të Eropës Juglindore, kanë krijimtari të pasur letrare, e cila i ka ndihmuar ata në rrugëtimin e tyre.



Roli i letërsisë dhe i arteve në shpërfaqjen e kësaj trashëgimie është i dukshëm, pavarësisht faktit se studiues të ndryshëm e minimizojnë rolin e saj dhe e mbitheksojnë rolin e veprimeve (politike) në mbijetesën historike të kombeve. Epika gojore, ta zëmë, i mbindërton “historitë letrare”. Jo rastësisht, vepra të shumta letrare shfaqen si “rimarrje” e “rithurje” e veprave të mëhershme, madje edhe atëherë kur autorësia e tyre është e pashprehur ose ekzistenca e këtyre veprave të hershme e padëshmuar.

Këngët osianike, të cilat i përmendëm në krye të këtij libri, sipas autorit të tyre Xhejms Makferson, janë “krijim bashkëkohor i një dorëshkrimi të gjetur”.<sup>1</sup> Ngjashëm, Uilliam Shekspiri i “rindërtonte” veprat e veta përmbi legjendat e hershme (veneciane, daneze etj.). Në letrat shqipe, Mitrush Kuteli i botonte rrëfenjat e veta nën emërtimin “Tregime të moçme shqiptare”.<sup>2</sup> Për autorët romantikë dhe pasromantikë, ndërkaq, ringjallja e një bote të hershme, e “tregimeve të moçme”, pati funksion jo vetëm të rikrijimit të formave letrare, por edhe të ringjalljes së shpirtit të kombit, por edhe të miteve, këngës dhe ndjenjës për vetveten.

Kësisoj, shenjat etnosimboliste, të pranishme në jetën e gjallë të kombeve, qenë “krua i pashtershëm”<sup>3</sup> për letërsinë. Ato e ndihmuan zhvillimin e një fare të saj, të lidhur për shenjash etnike, pothuajse në të gjitha periudhat e zhvillimit të saj, sidomos në romantizëm. Kthimi drejt këtyre shenjave e ndihmoi atë që ta kultivonte më tej nënshtresën epike dhe ta ndërlihte ekzistencën e saj me paraardhësen e vet, traditën letrare gojore.

Në anën tjetër, “legjitimiteti” për t’iu rikthyer jo vetëm shenjave dalluese të popujve, por edhe historisë së formave narrative mbi bëmat epike, që iu atribuua letërsisë, e ndihmoi atë që t’i zgjeronte kufijtë e vet dhe të krijonte një diskurs rrëfimtar të afërt me ambientin në të cilin zhvillohej.

Por, as letërsia e romantizmit, as vetë ideologët e formimit të kombeve nuk do të mund ta përlligjinin si të vetmin arsyetim për krijimin e kombeve ekzistencën e këtyre shenjave etnosimbolike dhe rrëfimitarisë

---

1. Thiesse, *Krijimi i identiteteve kombëtare...*, e cit., fq. 138.

2. Mitrush Kuteli, *Tregime të moçme shqiptare* (“Mitrush Kuteli”, Tiranë, 2012).

3. Term i Bogdanit.

popullore mbi to. Duhej veprim politik për ta bërë të mundur krijimin e kombeve. Prandaj, etnosimbolizmi, sado thelbësor për krijimin e vetëdijes mbi kombet do të ishte i pamjaftueshëm për ta përlligjur ekzistencën e kombeve pa një vendimmarrje të theksuar politike, e cila është e ndërlidhur me zhvillimin kulturor, por edhe ekonomik e social të popujve. Kjo, mbase e përlligj edhe vetë kategorizimin e kombeve sipas origjinës së krijimit të tyre në kombe kulturore, parabaza e së cilave është ekzistenca e një kulture historike dhe narrative mbi të, si dhe kombet politike, të cilat krijohen mbi vendimmarrjen politike dhe janë produkt i zhvillimit industrial e shoqëror.

Porse, identifikimi i paraadhësve kombëtarë nëpërmjet narrativës së hershme, si dhe identifikimi me ta nëpërmjet ringjalljes së miteve mbi vetveten e rikrijimit të rrëfimeve gojore mbi bëmat “historike”<sup>1</sup> të tyre, ka qenë shumë i rëndësishëm dhe e ka mbajtur letërsinë të lidhur për një kohë të gjatë me truallin në të cilin kanë lindur epopetë e mëdha.

Natyrshëm lind pyetja: a janë kombet struktura të trashëguara, apo janë krijesa politike dhe cili është raporti i letërsisë me to? Pyetja e dytë bëhet veçanërisht e rëndësishme në rast se e pranojmë si të mirëqenë hamendësimin se ato janë krijesë e një vendimmarrjeje politike? Si mund të kërkojë letërsia tema e motive mbi tejkohshmëritë nëse pikëvështrimi i saj ngushtohet në vendimet e një brezi dhe nuk paraprihet nga disa struktura të trashëguara, qofshin ato edhe mitike, mbi të cilat i krijon tejkohshmëritë letrare? Pa dyshim që ngritja e vetëdijes për ekzistencën e hershme të kombit është po kaq e rëndësishme sa vendimi për ta shtyrë përpara artikulimin politik mbi ekzistencën e tij. Edhe pse duken të papërputhshme, këto premisa duhet ta kenë pasur të përbashkët rrugën e tyre në histori. Prej këtej rrjedh edhe mundësia që parimet etnosimboliste të shihen të pashkëputura nga synimet për vendimmarrje politike.

---

1. Raporti i “historikes” me “letraren” ka qenë vazhdimisht i ndërligjshëm. Aristoteli theksonte se të dyja kërkojnë të vërtetën. Tekstet e diskursit imagjinar kanë provuar vazhdimisht ta dëshmojnë këtë “të vërtetë”, e cila një herë ishte dritë hyjnore, pastaj thelb i jetës njerëzore etj. Në romantizëm imagjinarja dhe historikja fillojnë të dallohen qartë.

Teoritë liberale mbi kombformimin e relativizojnë përpjekjen për t'i trajtuar përkatësitë kombëtare si të trashëguara dhe etnosimbolet si të përjetshme. Ato zbehen nën lupën e përpjekjeve të ithtarëve të ngritjes së strukturave mbikombëtare (organizatave të përbashkëta politike).

Në pikëvështrimin e tyre, besnikëritë kombëtare, pra besimi në përkatësinë tonë si anëtarë të një kombi është gjenetikisht e përcaktuar, është “instiktive” dhe nuk përkon plotësisht me realitetin, së paku jo me atë modern, sipas të cilit “kombësitë janë krijime të ndërgjegjshme të njerëzve”.<sup>1</sup> Kjo nënkupton që përpjekja për të dëshmuar trashëgimi historike, etnokulturë dhe traditë të hershme, e vë në krizë domosdonë e ekzistencës dhe të përdorimit të shenjave etnosimboliste për ta dëshmuar ekzistencën e kombeve.

## *Modernizmi*

Modernizmi, lëvizje e madhe në kulturë, arte e letërsi në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, shfaqti pikëpamje të fuqishme edhe mbi zhvillimin e kombeve, duke u shndërruar në njërën ndër paradigmat e fuqishme mbi formimin e tyre. Duke besuar fuqishëm në zhvillimin industrial dhe në fuqinë mendore, modernizmi mundësoi lindjen e besimit në vetvete dhe, si rezultat, besimin se zhvillimi social mund të jetë përcaktues për të ardhmen e shoqërive. Kësisoj, ai provoi shmangien nga tradita dhe kërkimin e formave progresive për organizimin e jetës. Në rrafshin e teorive kombformuese, modernistët, si Benedikt Andersoni, Erik Hobsbaumi, Ernest Gellneri etj., lindjen e kombeve e shihnin të lidhur me zhvillimin urban, social e ekonomik, si dhe me ngritjen e vetëdijes për leximin, shtrirjen mediale e zgjerimin e imagjinatës. Sipas këtij koncepti, lindja e kombeve ndërlihdhet me fundshekullin XVIII, kur nis zhvillimi industrial modern.

Kodifikuesi i kësaj teorie, Benedikt Andersoni, e krijonte ndërlihdjen e fuqishme mes industrializimit të shoqërisë dhe lindjes së medimeve të shkruara, të cilat krijuan mundësi të pakufishme për artikulum të qëndrimeve dhe për organizim të qytetarëve rreth disa

---

1. D. Miller, *Mbi kombësinë*, e cit., fq. 20.

“pikëpamjeve të përbashkëta”.<sup>1</sup> Në këtë periudhë, e cila kohësisht përkon me lindjen e një vetëdijeje të re mbi kombin, mjetet e informimit e të komunikimit ndikuan në shtrirjen e ideve për vetveten dhe krijuan nënshtresë për lindjen e lëvizjeve të fuqishme nacionale dhe artikulimin e kërkesave për lirinë dhe vetëvendosjen e popujve. Pra, për Andersonin vetë nacionalizmi është artefakt kulturor modern. Ai ndikoi në lindjen e revolucioneve teknologjike e kulturore që përshpejtuan në krijimin e vetëdijes për kombet e organizuara politike.

Porse, vetëdija nacionale nuk është e njëkohshme me ekzistencën e kombeve dhe nuk e prek substancën e krijimit. Kombet mund të jenë shumë më të hershme sesa lindja e vetëdijes për rolin e tyre në histori. Nacionalizmi ngrihet mbi një nënshtresë të hershme, artefaktore, së cilës i shërben. Madje, pikërisht ekzistenca e formave parakombëtare (etnisë, ta zëmë) e bën të mundur lindjen e vetëdijes për të. Shtypja dhe shpërndarja e mijëra librave, zhvillimi i shtypit dhe i botimeve në gjuhët e popujve të ndryshëm (gjuhët vernakulare) bëri të mundur qarkullimin e ideve mbi vetveten dhe krijimin e vetëdijes nacionale. Veçse, kërkesa për botimin e librave në gjuhët popullore duhet të ketë qenë e lidhur me ekzistencën e një *kulture fetare popullore*,<sup>2</sup> e cila kulturën fetare e zbërthente përmes thjerrëzave të kulturës popullore. Kjo ndikoi që krishterimi apo islami të përziheshin me elementë paganë, pra që feja universale të shartohej me elementë lokalë, të cilët mbijetonin nën petkun universalist. Megjithatë, nuk mund të themi me saktësi nëse përdorimi më i shpeshtë i gjuhëve lokale (popullore) në jetën fetare t’i ketë dhënë shtytje botimit të teksteve liturgjike në këto gjuhë ose jo, ngase, sikur dihet, përkthimi i librave fetarë në gjuhë të kuptueshme nga populli mund të ndikojë në krijimin e një besimi edhe më rigoroz të fesë dhe gërryerjen e elementeve të traditës lokale, por, po kështu, ta përforcojë më tej kulturën fetare lokale. Këtu na mungon metodologjia shkencore për të dhënë gjykim të prerë nëse përkthimi i librave në gjuhën shqipe nga Buzuku e të tjerët e përforcoi më tej bindjen në kanonet e fesë universale, apo e zgjeroi më tej kulturën

- 
1. Benedict Anderson, *Imagined Communities: Reflections on the Origin and Spread of Nationalism* (Verso Editions and New Left Books, London, 1983). Cituar sipas botimit në gjuhën shqipe: Benedict Anderson, *Komunitete imagjinare*, përkthyer nga: Brenton Kotorri (“Dy lindje & Dy perëndime”, Tiranë, 2013).
  2. Shih: G. Petrotta, *Zhvillimi historik...*, i cit., fq. 54.

popullore. Por, është e vërtetë dukshme se përkthimi i librave fetarë ka ndikuar në krijimin e një kulture letrare lokale. Ky përbën argument të mjaftueshëm për të konstatuar se përkthimi dhe botimi i tyre pati efekt të dukshëm kulturor, duke qenë se e përforcoi lidhjen e pashkëputshme mes synimeve të grigjës (bashkësive fetare) dhe synimeve kulturore. Përkthimi i librave është i lidhur pashmangshmërisht me këtë kulturë letrare, duke qenë se kërkohej që jo vetëm pagëzimi (sikur kërkonte Pal Engjëlli), por edhe liturgjia të zhvillohej në gjuhën shqipe.

Afërmendsh, synimi i pjesëtarëve të këtyre bashkësive kulturore (fetare) nuk ishte që të dëshmonin përkatësi etnike nëpërmjet shkrimit, as ta forconin kulturën shkrimore të tyre, por që ta bënin të kapshme liturgjinë, ritet fetare, në gjuhën e tyre. Kjo, megjithatë, mjaftoi që letërsia shqiptare të zinte fill, që të shkruheshin veprat e para në gjuhën shqipe dhe që kultura fetare popullore të mundësonte lindjen e një kulture shkrimore shqipe. Po të mos ekzistonte kjo kulturë nuk do të bëhej i nevojshëm as shkrimi (filobiblist) e, rrjedhimisht, letërsia shqipe, shkrimtaria në gjuhën shqipe, do të lindte më vonë. E dukshme: tekstet botoheshin para së gjithash për qëllime fetare, pasi feja ofronte horizontin brenda të cilit njerëzit gjenin vlerat, frymëzimin dhe arsyet për të shkruar. Porse, duke i artikuluar këto kërkesa, autorët e tyre e ndihmonin lindjen e një tradite shkrimore dhe të një kulture letrare në gjuhën shqipe.

Kjo përvojë historike na mëson se lëvizjet kombëtare i kërkojnë rrënjët e tyre në shtresimet kulturore, pavarësisht a krijojnë referencë me to apo jo. Ato nuk mund të jenë vetëm “imagjinare”, sikur këmbëngulte Andersoni, i cili theksonte se anëtarët e bashkësive etnike / kombeve e pranojnë përkatësinë e tyre si pjesë e një “bashkësie imagjinare”, ngaqë nuk do ta njohin kurrë njëri-tjetrin, por do të besojnë se janë pjesë e asaj bashkësie. Por, është pikërisht kjo bashkësi, si shumësi vlerash të trashëguara, e shtresuar në përkatësinë e përbashkët, ajo që e bën të mundur ndjenjën e përkatësisë. Njerëzit i njohin dhe u besojnë disa artefakteve, simboleve etnike, kulturore e gjuhësore, të cilat e bëjnë “përkatësor” (ia krijojnë ndjenjën e të pasurit të një lloji përkatësie kolektive) si njërit ashtu edhe anëtarit tjetër të bashkësisë, edhe kur ata vetëm mund “ta imagjinojnë njëri-tjetrin”, pra ngjashmërinë mes tyre.

Ata e imagjinojnë si përkatësi traditën e shtresuar në ndërdijen për vetveten. Lëvizjet nacionale, të cilat e shpërfaqin përfytyrimin për vetveten, në fakt i zbulojnë rrënjët e ngulitura në histori. Tërthorazi Andersoni e pranon këtë. Madje, ai pranon edhe një fakt tjetër shumë të rëndësishëm për qasjen që ne po ndjekim në këtë libër. Ai dëshmon se lëvizjet nacionaliste janë bërë të mundura vetëm duke u mbështetur në parimin kulturor, i cili njih pashkëputshmërinë në kultivimin e disa shenjave përkatësore dhe bën të mundur kapërcimin nga vetëdija për të përbashkëtën religjioze (në mesjetë) në atë etnike, më vonë, edhe pse ai përfill parimin e pashkëputshmërisë si mjet përmes së cilit ndërtohet ideja e kombit dhe nga e cila lindin lëvizjet nacionaliste. Vetë ai ofron shembullin e vyer të kësaj pashkëputshmërie, atë të kolonizimit spanjoll, i cili, megjithëse pothuajse zhduku gjuhët e vendit dhe ua ndërroi fenë popullsisë vendase, nuk e zbehu pashkëputshmërinë me vlerat historike dhe përpjekjen për t'i mbajtur gjallë ato. Dominimi spanjoll, sipas tij, vetëm sa e ngjalli veprimin e elitave spanjishtfolëse, të cilat krijuan idenë e një vije lineare historike që i ndante ato nga Spanja, në emër të nevojave politike. Pra, ai besonte se rrënjët kulturore të kombit qëndrojnë në themel të lëvizjeve nacionaliste për jetësimin e kombit.

Autorët e vjetër shqiptarë, Buzuku, Budi, Bogdani etj., patën synim përforcimin e bashkësisë së tyre fetare, qëllim të cilin ata e arritën vetëm pjesërisht, ngase veprat e tyre nuk gjetën përdorim të gjerë e të menjëhershëm. Këtë e dëshmon fakti se veprat e tyre humbën në histori dhe u zbuluan shumë më vonë, por edhe për faktin se kultura që ata synonin u dominua shumë shpejt nga islamizimi dhe se popullsia ishte thuajse tërësisht analfabete. Sido që të jetë, duke ecur teht të religjiozes, por të religjiozes së ngulitur fort në kulturë, ata ndikuan në përforcimin e ndjenjës së përbashkësisë. Në romantizëm kjo lidhje do të shërbejë si parabazë për ngritjen e kësaj ndërdijeje në vetëdije (nacionale) për veten, pra në vetëdije për përkatësinë. Rënia e dinastive mbretërore që legjitimoheshin përmes fesë, por edhe transformimi i idesë mbi vetveten si rezultat i industrializimit, përparimi i botimeve dhe kujdesi ndaj gjuhëve vernakulare, mundësuan vetëdije të re mbi vetveten e mbi rolin tonë në histori, prandaj mundësuan edhe lindjen

e lëvizjeve nacionaliste, si rezultat i kërkimit “të dëshmimit” të këtyre rrënjëve në histori dhe jo i krijimit të tyre.

Kombet, prandaj, nuk janë të reja, ato janë të dëshmuara në histori. Perceptimi për vetveten mund ta përforcojë ekzistencën e rrënjëve të hershme kulturore e ndjenjën e dëshmimit për to. Në rastin e kombeve politike ato ndikojnë në lindjen e një krijese politike, e cila provon t’u imponojë atyre disa dimensione jashtëkulturore.

Hobsbaumi, sipas pikëpamjes moderniste që i prekte kufijtë e teorive marksiste, i shihte revolucionet (para së gjithash atë francez dhe anglez) si artefakte të cilat e transformuan idenë për kombin në një vetëdije të theksuar nacionaliste. Përlindja e kombeve (*nation-to-be*) u shndërrua në synim parësor të nacionalistëve.

Ideologjia dhe nacionalizmi janë të trashëguara, por vetë kombet janë produkte të “modernizimit”.<sup>1</sup> Ato janë “të ngulitura historikisht”, duke qenë se për t’u formësuar nacionalizmi i kërkon kulturat e trashëguara materiale. Nuk është e thënë që ato të jenë medoemos etnitë, bërthamat zanafillore të ekzistencës së kombeve.<sup>2</sup> Ato mund të jenë: territori dhe popullsia (e cila për etnosimbolistët nënkupton kulturën e përbashkët).<sup>3</sup> Kjo e përjashton teorinë sipas së cilës kombet nuk mund të jenë tejhistorike dhe se krijimit të tyre duhet t’i paraprijë kultivimi i një vetëdijeje për të:

*Nacionalizmi i paraprin krijimit të kombeve.*<sup>4</sup>

Pra, sipas Hobsbaumit, kombet nuk i referohen plotësisht kulturës së trashëguar dhe historisë së përbashkët të anëtarëve të tyre. Së paku jo

---

1. Shih: Ernest Gellner, *Culture, Identity and Politics*, e cit.

2. Sipas Smithit dhe Donald Horowitz-it, etnitë janë “popullata të caktuara të cilat kultivojnë mite të përbashkëta për antikitetin, kujtesën e përbashkët historike, për një ose më shumë elemente kulturore, si dhe për lidhjen e pashkëputshme dhe të përhershme me “vendin e të parëve” (*homeland-in*) dhe e ushqejnë ndjenjën e solidaritetit të përbashkët, së paku mes elitave. Shih: A. D. Smith, *Myths and Memories of the Nation*, e cit., fq. 13.

3. A. D. Smith: *Ethno-symbolism and Nationalism...*, vep. e cit., fq. 7.

4. Eric Hobsbawm, *Nations and Nationalism since 1780 - Programme, Myth, Reality*, second edition (Cambridge University Press, Cambridge, 1992), fq. 10.

vetëm atyre. Ato janë thjesht rezultat i një vetëdijeje mobilizuese për ta krijuar atë, pra i një lloj nacionalizmi të theksuar, fryt i të cilit do të jetë lindja e kombeve.

Për Hobsbaumin, e trashëguara që është e zonja ta formësojë idenë e kombit, pra të shndërrohet në ndërdije kombëtare, nuk është e mjaftueshme për qëndrueshmërinë e kombeve. Ngjashëm me perenialistët, edhe Hobsbaumi e kërkonte një lloj plebishiti mes anëtarëve të një bashkësie, të cilët ia përcaktonin vetes përkatësinë. Pra, baza kombëtare është e pamjaftueshme pa përcaktimin politik të anëtarëve të bashkësisë. E, sikur mund të merret lehtësisht me mend, Hobsbaumi e pranonte konceptin sipas të cilit kombet janë derivat i lëvizjeve nacionaliste të shek. XIX dhe e shihte të lidhur me lëvizjet e mëdha politike të asaj kohe. Në pikëvështrimin e tij, kombet janë më shumë politike se kulturore. Parabaza kulturore e tyre, sikur u shtrua më lart, mund të jetë e domosdoshme për të krijuar ndjenjën e së përbashkëtës historike, “elementit kombëtar”, të nevojshëm për identifikimin e vlerave të përbashkëta, por ajo nuk mund të jetë vendimtare për formimin e kombeve. Duhet një shtysë politike, rezultat i një vetëdijeje të lartë për vetveten, që këto bashkësi të lartësohen si kombe.

Kombet (politike) lindin në një moment të caktuar historie, si rrjedhojë e shtysës së fuqishme të nacionalistëve kombformues. Vetë kjo vetëdije kombformuese (e artikuluar si vetëdije nacionaliste) është fryt i një momentumi historik, sikur janë edhe vetë kombet. Ajo i paraprin krijimit të tyre dhe nuk është e trashëguar historikisht, sikur nuk janë të trashëguara as kombet, të cilëve u referohet. Ajo lind në një moment historie dhe synon përlindjen e kombeve! Rrjedhimisht, “nacionalizmi është projekt i cili synon që t’i përlindë kombet”.<sup>1</sup> Ai nuk i njeh tejkohshmëritë historike, kulturore, religjioze e etnike si paraformacione, së cilave u referohet lindja e kombeve. Madje, edhe vetë ideja e nacionalizmës është moderniste.<sup>2</sup>

Deri këtu koncepti i Hobsbaunit është i përafërt me atë të modernistëve, por fakti se ai e pranon që bashkësitë synojnë ringjalljen e traditave nëpërmjet “shpikjes” (rishpikjes) së tyre, e për afron atë me

---

1. Ph. Schwyzer, *Literature, Nationalism and Memory*, i cit., fq. 75.

2. Shih: Benedict Anderson, *Imagined Communities...*, i cit.



konceptin e etnosimbolistëve, sipas të cilit disa tradita, zakone e shenja janë të tejkohshme. Duke u ripërtërirë ato shndërrohen në “repertor përdallues” të kombeve dhe dëshmojnë për lashtësinë e tyre, duke e bërë të mundur diskutimin për përhershmërinë e kombit, si paradigmë mbi të cilën duhet t’i kërkojmë rrënjët e ekzistencës së tij. Thelbësor për pikëvështrimin tonë, megjithatë, mbetet koncepti i tij mbi “përputhshmërinë” ndërmjet njësisë kombëtare dhe asaj politike.

*Nacionalizmi, në thelb, është parim, sipas të cilit njësia politike dhe njësia kulturore duhet të përputhen.*<sup>1</sup>

Kjo nënkupton që ekzistenca e kombeve kulturore e përligj kërkesën për legjitimim politik të tyre. Në këtë rast njësimi kulturor (nacioni i atë Anton Harapit) e kërkon njësimin politik, si rezultat të lëvizjeve nacionaliste, synim i së cilave është emërtimi i kombeve sipas përmasës së ekzistencës së tyre kulturore. E, duke qenë se këto përmasa përputhen plotësisht me njëra-tjetrën, legjitimi bëhet i mundur.

Por, nëse ky lloj njësimi është i vështirë për shkak të mospërputhjes së plotë mes ekzistencës historike, përmasës së trashëguar kulturore dhe ambicieve ose shtysave politike, atëherë kombet e humbin pashkëputshmërinë e ekzistencës kulturore dhe kërkojnë kornizë politike për vetveten. Kësisoj, lindin kombe politike, më saktësisht shtet-kombe, të njohura për historinë politike të Europës.

Pikëpamjet e tilla janë të rëndësishme për letërsinë. Ringjallja e miteve të vjetra, ndër të cilët ai për lashtësinë e kombit është thelbësori, pastaj “shpikja” e traditave të cilat e dëshmojnë katërcipërisht “këtë lashtësi” të ekzistencës dhe aftësia për të krijuar mite të reja, sikur janë himnet kombëtare ose flamuri kombëtar, letërsisë (por edhe arteve të tjera, muzikës para së gjithash) i krijojnë mundësinë e artë që të zgjerojë objektin e vet: tashmë ajo bëhet kumbuese artistike e ideve të kombit, sikur që, nëpërmjet formave artistike e letrare i krijon mundësi atij (kombit) që të shprehë pikëpamjet e veta.

---

1. Eric Hobsbawm, *Kombet dhe nacionalizmi nga 1780 - Programi, Miti, Realiteti* (“Toena”, Tiranë, 2012), fq. 21.

Në rastin e lëvizjeve romantike, kombi kulturor është përputhur me atë politik, së paku në rastin e shqiptarëve. Romantikët shqiptarë kërkonin krijimin e shtetit shqiptar të përputhshëm me përmasën kulturore të kombit dhe synonin identifikimin e tij me tokën e të parëve, me traditën kulturore dhe me rrënjët historike e gjuhësore. Të vetëdijshëm se për ta përligjur njësimin kombëtar duhej mekanizmi i shtetit (sajesë e modernizmit), ata kërkonin rilindjen e shenjave “të trashëguara”, të cilat në kuptimin hobsbaumian ose andersonian janë “shpikur” prej lëvizjeve kombëtare. Prandaj, kombi (politik) është rezultat i lëvizjeve kombëtare dhe i vendimmarrjes politike për të.

Himnet kombëtare, ta zëmë, u shndërruan në objekt të pëlyqer për shkrimtarët romantikë. Duke qenë formë letrare,<sup>1</sup> himni u shndërrua jo vetëm në mjet shprehjeje, por edhe këngëtimi.<sup>2</sup> Ato e formësojnë ndjenjën e bashkësisë, sepse kthehen në bërthama të një përkatësie të përbashkët dhe u përgjigjen mitologjive kombëtare. Më tej, flamuri, “shpikje” e re e traditës, u shndërrua po kështu në objekt të dashur për letërsinë. Me dhjetëra tekste letrare iu kushtuan atij sikur simbolikës së trashëguar nga e cila mund të marrë hov ideja për formimin e kombit. Në letërsinë shqipe, ndryshe nga letërsitë e tjera, këto dy simbole u bashkëdyzuan në himnin kombëtar, i cili është *himn për flamurin*. Aty njëri simbol, himni, i thur lavd simbolit tjetër, flamurit.

Ernest Gellneri, në anën tjetër, e shtronte hamendësimin nëse këto simbole kombëtare dhe kultura e shtresuar janë të mjaftueshme për ta krijuar kombin, apo duhet lëvizje e madhe nacionaliste që mbi këto premisa të krijojë kombin? Ngjashëm me Andersonin, ai e pranonte ekzistencën e një kulture të hershme si premisë për formimin e kombit, por theksonte se ajo nuk mund ta legjitimonte këtë ekzistencë. Kësisoj, kultura e trashëguar shërben si një lloj “depoje”, e cila e kërkon legjitimimin politik.

- 
1. Forma origjinale e tyre duhet kërkuar brenda kishës. Ato janë pjesë e ritualit që ideologjitë shekullare, si nacionalizmi, e morën nga kisha dhe e përdorën për qëllime të tjera.
  2. Për raportin e himneve me simbolikën nacionale shih edhe artikullin: Vehbi Miftari & Suada A. Dzogovic, *A Symbol lauding another Symbol - National Anthems; Inter-symbolic Play*, në: *Lingua montenegrina*, viti XIV/1, nr. 27, Podgoricë, Mali i Zi, 2021, fq. 357-365.

*Duket sikur kulturat janë depo legjitimiteti politik.<sup>1</sup>*

Në raport me të tjerët, popujt e përdorin këtë kulturë ose artefakt “të fjetur” për ta legjitimuar politikisht një lëvizje të fuqishme nacionaliste, të mbështetur në arsim. Ajo e ngjall këtë ndjenjë të fjetur dhe e shpërfaq atë botërisht. Kësisoj, nacionalizmi bëhet jo vetëm trumbetues, por edhe krijues e stabilizues i kombeve, ngase i legjitimon ato politikisht në një lëvizje e cila buron kryekrejt nga vetëdija e ngritur nëpërmjet leximit dhe arsimit.

*Nuk janë kombet ato që shfaqin nacionalizmin, por anasjelltas, është nacionalizmi ai që krijon kombet.<sup>2</sup>*

Kësisoj, Gellneri i vuri bazat e një teorie *ideologjike-kulturore*, sipas së cilës kombet nuk janë vetëm simbolike (as vetëm artefakte), por edhe politike, ngaqë e përdorin kombëtarizmin si shtysë për formimin e tyre. Tekefundit, për konceptin modernist është e pranueshme që *përbashkësia*<sup>3</sup> ekziston jo vetëm në kulturën e shtresuar dhe në artefaktet historike, por edhe në qasjen që ne e krijojmë në raport me pjesëtarët e së njëjtës bashkësi, madje jo vetëm në historinë e formimit të asaj bashkësie, por edhe në jetën reale të saj. Kombet janë “biologjike” për aq sa e dëshmojnë këtë “prejardhja” dhe simbolet e tyre, por jetueshmëria e tyre varet nga shtypa të tjera, kulturore e politike. Ngjashëm me Hobsbaumin, programin ideologjik të kombit Gellneri e shihte në njësinë e re shtetërore, me organizim të ndryshëm nga ai i dinastive tradicionale: shtetit-komb. Të vetëdijshëm se kombi paraprihej nga etnosi, ata provuan që përkatësinë etnike ta kthenin në premisë për program politik për shtet-formimin. Ata (Gellneri, Hobsbaumi e Andersoni, më pas) kanë dashur të dinin se cila ishte zanafilla e shtetit-kombëtar. Ndaj, janë marrë me tregun, industrializimin, urbanizimin, si procese që zhbënë bashkësitë e vjetra bujqësore dhe të izoluara, të lidhura keq dhe panë se si tregu i shkriu ato, i homogjenizoi dhe i nxori nga izolimi.

---

1. Ernest Gellner, *Kombet dhe nacionalizmi* (“Rizoma”, Prishtinë, 2009), fq. 107.

2. Shih kapitullin e tretë të librit të tij.

3. Nocion yni, i përafërt me atë të Maks Veberit: *zusammenghörigkeit*.

Smith, nga ana tjetër, nuk ka këtë qëllim. Ashtu si edhe entosimbolistët, ai nuk merret vetëm me krijimin e shteteve kombëtare, por edhe me lidhjen simbolike, kulturore mes etnosit dhe kombit. Pra, nuk është thjesht tregu dhe kombi nuk është thjesht një stisje intelektuale. Nëse do të ishte e tillë, thotë Smith, kombi do të shkërmoqej. Kurse Treitschke, Renan etj. kanë pasur si qëllim të justifikojnë ndërtimin e shteteve kombëtare mbi parime të trashëgimisë së pandryshuar historike. Ata ishin si rilindësit tanë. Renan ishte i vetëdijshëm që francezët duheshin bërë, por kërkoi të ndërtonte një themel ku harresa ishte me rëndësi jetësore për të shkruar gjithë banorët e mbretërisë së Francës në një njësi shoqërore që do të bënte më pas qytetarin francez - qoftë ai normand, bask, breton, oksitan - që flisnin gjuhë krejtësisht të ndryshme dhe të pakuptueshme.

Ja pse kombëtarizmi mund të shndërrohet në “përçues” të kulturës së përbashkët dhe, rrjedhimisht, të formimit të përkatësisë kombëtare, me kushtin që ai të shërbejë si bartës i ndryshimeve sociale dhe i mobilizimit të njerëzve, por të mos i shkulë rrënjët kulturore e etnike të tyre. Kozmopolitizmi shfaqet si mjet rrafshues, ngase nuk e përfill ndryshueshmërinë (diversitetin) kulturor e etnik. I tillë ka qenë marksizmi. Pra, tendenca e “përfaqësimit” të kulturës në një vijë ideologjike jo rrallë përdor mjete përjashtuese për veprimtari kulturore, letrare po se po, të kombeve.

Sido që të jetë, ideja e nacionalizmit ka qenë njëra ndër shtysat e mëdha për përforsim të përkatësisë dhe homogjenizim të bashkësive etnike përmbi një nënshtresë kulturore. Letërsia e romantizmit e shpërfaq më së miri këtë premisë. Megjithatë, natyra e saj, por edhe mjetet të cilat përdor ajo, janë të pamjaftueshme për ta shpërfaqur gjithë synimin e kombeve, i cili është edhe politik, përveçse kulturor. Për këtë arsye lëvizjet romantike janë pasuar nga një diskurs i fuqishëm filozofik e eseistik, i cili ka provuar që të përcaktojë idealogjinë (jo: ideologjinë) e kombeve dhe t’i homogjenizojë ato rreth disa vlerave të përbashkëta. Vitet ’30 të shekullit XX, ta zëmë, provojnë ta krijojnë kornizën etike e filozofike të zhvillimit të kombit shqiptar. Në ato vite autorë të shumtë përcaktojnë edhe premisat dhe kahet e zhvillimit nacional të shqiptarëve. Por, këtyre do t’u kthehemi në librat e mëpastajmë.

## *Perennializmi*

Ndryshe nga modernistët, perenialistët<sup>1</sup> e shohin zhvillimin e shoqërisë si rezultat të besimit në të vërtetat universale. Mbi të janë ngritur parimet dhe dija e përgjithshme. Ata besojnë se idetë, parimet ose vlerat mbi të cilat janë ngritur kombet janë të përhershme, ato janë përcaktuar nga një e vërtetë universale, në një moment të caktuar historie. Rrjedhimisht, ato janë të gjithëkohshme.<sup>2</sup> Ernest Renan e Heinrich von Treitschke mbronin idenë se kombet janë të bartura historikisht. Në formimin e tyre kanë luajtur rol dinastitë, fuqizimi i disa familjeve, princërve ose grupeve dhe ndikimi mbi familjet ose grupet e tjera, të cilat janë bashkuar përreth tyre. Një familje e fuqishme shndërrohet në qendër përbashkuese edhe për familje të tjera, të cilat, megjithëse me trashëgimi tjetër (gjuhe e gjaku), afrohen dalëngadalë përreth saj, duke e pranuar trashëgiminë e saj sikur të ishte e tyre. Forca e saj afron dhe bashkon jo vetëm anëtarët ose pasardhësit e familjeve të një gjaku, por edhe të gjithë ata që fati historik i ka lidhur me njëri-tjetrin. Me kalimin e kohës, fiset e tjera, të cilat nuk kanë lidhje gjaku, duke qenë se motivohen nga veprat e mëdha të fisit udhëheqës, i bjerr dalëngadalë harresa dhe nisin e njëjtësohen me të.

Pra, harresa luan rol të madh në përafrimin e njerëzve përreth udhëheqësit që del mbi të tjerët, familjes me tipare, rite e zakone të veçanta, ose fiseve, forca përbashkuese e së cilave është e tillë që t'i tërheq edhe fiset e tjera brenda "kulturës" së vet. Homogjenizimi i tyre i nënshtrohet rrjedhës historike dhe veprimit politik. Elementi i dytë i cili sipas perenialistëve ka ndikuar në përafrimin e tyre është "aristokracia militare", ose ndërhyrja e shtetit. Fiset pranojnë të përbashkohen përreth njërit fis, të cilin e çmojnë si më të rëndësishmin mes tyre dhe të cilit dëshirojnë t'i ngjajnë. Madje, e bëjnë këtë deri në atë masë sa një ditë duan të identifikohen plotësisht me të, duke i harruar rrënjët e veta, të cilat i kanë sjellë me vete kur kanë rënë në kontakt për herë

- 
1. "Perennial", nënkupton të gjithështrirën, të gjithëkohshmen, shumëvjeçaren. Pra, diçka që ka lindur me njerëzimin dhe që është bartur historikisht.
  2. Anthony D. Smith, *Ethno-symbolism and Nationalism - A cultural approach*, e cit., fq. 3.

të parë me fisin dominues dhe ia kanë shfaqur me krenari ato. Kështu, kryesisht për shkak të elementit të përmendur më herët, harresës, dhe kërkesës për vetidentifikim me atë që priret të shndërrohet në fis dominues, ata i nënshtrohen vullnetit të hekurit të fisit prijës dhe bëhen shkallëshkallshëm pjesë e botëkuptimeve të tij.

Veçse, duke u bërë pjesë e një kulture dominuese<sup>1</sup> ata e ndryshojnë (pahetueshëm) edhe vetë atë. Kësisoj, kultura dominuese mund të krenohet se “i përbrendëson” kulturat e tjera, duke i shndërruar pak nga pak në pjesë të skajshme (periferike) të kulturës së vet, por në të njëjtën kohë nuk mund të mos pranojë se ky “përbrendësim”, i shoqëruar me “tëhuajësim” të vlerave të kulturës së nënshtuar nuk ka sjellë një lloj ndryshimi, sado të vogël, edhe në vetë kulturën dominuese. Ajo nuk është më plotësisht homogjene, edhe nëse ndikimi i kulturës/kulturave të përbrendësuar (lexo: asimiluara) duket sikur është i pëpërfillshëm. Renan merrte një shembull nga historia e Europës. Nëse i referohemi kësaj historie, ne do të thoshim se popuj të fismë, sikurse janë gjermanët, anglezët ose italianët, të cilët në të njëjtën kohë kanë pasur ndikim të madh në zhvillimin e kulturës europiane, duke qenë se janë pikëprekur me kultura të tjera, të cilat i kanë përbrendësuar, por edhe nga të cilat janë ndikuar, sot “janë mbase popujt më heterogjenë në kuptimin e gjakut”. Kombet më të rëndësishme janë edhe më të përzierat.

Pra, sipas perenialistëve bëma, epikja, sado e rëndësishme, nuk mund të shndërrohet vetvetiu në tejkohshmëri mbi të cilën mund të vlerësojmë formimin e kombeve. Përkundrazi, ajo është premisë mbi të cilën mund të projektohet ideali për vetveten, por duhet një “plebishit i përditshëm” mes anëtarëve të një bashkësie që të formohen kombet. E këto bashkësi janë të ndryshme. Ato i bashkon, sikur u tha, fuqia përbashkuese e një prijësi ose e një fisi dhe fuqia me të cilën ai i përafron ata përreth vetes.

Pra, edhe kur e trajtojmë “kombin” si *kategori* të përjetshme, të gjithëpranishme, ai është *bashkësi individësh*, të cilët në një moment të caktuar historie vendosin ta quajnë veten anëtarë të një kombi të caktuar.

---

1. Duket se “kultura dominuese” nuk mund të trajtohet ndaras nga synimet e heshtura hegjemonike, të cilat ajo i shpërfaq karshi “kulturave më të vogla” dhe kërkon t’i asimilojë brenda vetes.

Kësisoj, historikisht kombet mund të jenë krijuar dhe zhdukur, nuk ka kombe të përhershme e as dinasti të përjetshme, të cilat e paracaktojnë përkatësinë kombëtare të individëve, nëse ata nuk e pranojnë me plebishit të përditshëm se i përkasin asaj.

Për perenialistët, Renanin para së gjithash, ekzistojnë së paku dy pikëvështrime mbi prejardhjen e kombeve: sipas së parës, asaj *antropologjike*, kombet janë krijuar thjesht mbi një bërthamë elitare (një princ, një familje a një fis). Kategoria e dytë, ndërkaq, është historike. Sipas saj, kombet nuk janë e vërtetë e pamohueshme universale, e krijuar në një moment të largët historie dhe e bartur si e tejkohshme deri në ditët e sotme, por si rezultat i zhvillimit historik. Në themel të tyre ekziston një bërthamë e vogël me lidhje gjaku, por kombi krijohet vetëm nëpërmjet lidhjes përreth saj edhe të fiseve të tjera, kryesisht nëpërmjet aparatit të dhunës, si dhe imponimit të harresës së “përkatësive të pjeshme”.

Sipas këtij pikëvështrimi, ato (kombet) janë më shumë pjellë e marrëveshjeve politike, sesa e rrënjëve të përbashkëta. Kësisoj, ato janë *kombe politike* më shumë se *kulturore*. Ato mund të formohen e të shuhen, nëse marrëveshja mes anëtarëve të tyre nuk përtëritet. Perenialistët e kërkonin marrëveshjen politike ndërmjet anëtarëve të një bashkësie si parakusht për formimin kombeve dhe për ekzistencën e tyre.

Sikurse kuptohet lehtësisht, sa më thellë që përpiqemi të depërtojmë në natyrën e kombeve, aq më i vështirë bëhet shpjegimi i raportit mes tyre e letërsisë që krijojnë. Rrjedhimisht, edhe raporti ndërmjet letërsisë, imagjinatës a fikSIONIT dhe synimit për ekzistencën e kombeve është vështirë i përcaktueshëm. Letërsia vihet në lojë nga përpjekjet nacionaliste për ringjallje të “rrënjëve të hershme”, por, së paku në pikëvështrimin e perenialistëve, ajo nuk është mjet i domosdoshëm për motivim etnik. Ajo shpreh çfarë ekziston tashmë, u referohet strukturave të tejkohshme, por nuk përbën domosdoshmërisht element motivues për formimin e tyre.

Nëse e marrim si të mirëqenë pohimin se në nënshtresën historike të kombeve gjendet një bërthamë tepër e vogël njerëzish të një gjaku<sup>1</sup>

---

1. E. Renan thoshte se në të gjithë Francën mund të gjeje jo më shumë se dhjetë familje të cilat mund të dëshmonin origjinën e tyre franceze. Shih: Ernest Renan, “What is a Nation?”, në: Ernest Renan, *Qu'est-ce qu'une nation?*, e cit.

dhe se vetëm “aristokracia militare” i lidh ata në grupe, fise a bashkësi që e bjerrin kujtesën (e kultivojnë harresën), raporti i letërsisë me kujtesën e përbashkët sfidohet në themel: ajo e ndihmon kultivimin e ndjenjës së përbashkësisë nëpërmjet ringjalljes së miteve të hershme, por janë pikërisht kjo kujtesë dhe këto mite që e sfidojnë substancën e “asaj mase” së cilës i këndon letërsia. Duke i kënduar përbashkësisë ajo e legjitimon kultivimin e harresës. Fiset e shumta, të cilat i janë nënshtruar një fisi të vetëm ose një aristokracie udhëheqëse, dalëngadalë (edhe nën ndikimin e këngëve epike) kultivojnë harresën për përkatësinë e vet dhe paralelisht e pranojnë “kujtesën” e tjetrit, të fisit udhëheqës, sikur të ishte e tyre. Kjo, natyrisht, vlen vetëm në rastet kur fisi që i pranon vlerat përfaqësuese të fisit udhëheqës flet në gjuhë tjetër ose ka prejardhje të ndryshme etnike nga ajo e fisit sundues. Kur fisi udhëheqës flet të njëjtën gjuhë me fiset të cilat përbashkohen me të, përkatësia etnike nuk shuhet. Në këtë rast, ndryshim pësojnë nënkulturat. Ato mbijetojnë në rrafshin etnik, por “shfityrohen” në atë kulturor.

Gjergj Kastrioti mblodhi në Kuvendin e Lezhës<sup>1</sup> parinë arbë, e cila e njohu atë si pikë qendëruese. Lidhja e tyre përreth Skënderbeut nuk ka ndikuar në “harresën” e fiseve të tjera arbë, të cilat i ishin bashkëngjitur atij. Letërsia e humanizmit (së paku kjo jona) e vë në krizë parimin e perenialistëve sipas së cilit “shpata i ka përcaktuar përkatësitë”. Pa dyshim që fiset e tjera i qenë bashkuar Gjergjit në përpjekjen e tij kundër osmanëve. Por, këto fise nuk ishin të ndryshme, ato qenë fiset arbë, kishin në bërthamën etnike një kulturë të përbashkët. Ato nuk hiqnin dorë nga tradita e vet me rreshtimin e forcave të tyre përreth Gjergjit. As nuk qe e nevojshme që të përdorej “aristokracia militare” për t’i bashkuar në një strukturë “të ndryshme” nga tradita e mëhershme. Gjergji kthehej si çlirues i tyre dhe jo si

---

1. Kuvendi i Lezhës, i njohur ndryshe si Kuvendi i Princërve Shqiptarë, u mbajt më 2 mars 1444 në Katedrelan e Shën Nikollës, në Lezhë (asokohe zotërim i Venedi-kut). Në të morën pjesë princërit shqiptarë: Gjergj Arianiti, Andrea Topia, Nikollë Dukagjini, Pal Dukagjini, Teodor Muzaka, Lek Zaharia, Lek Dushmani, Gjergj Stres Balsha, Pjetër Spani, Stefan Cernojeviçi etj., Kuvendi krijoi “Lidhjen Shqiptare” me Skënderbeun si kryetar të saj me titullin: “Kapiten i Përgjithshëm” (Capitaneus Generalis). Burimi: <https://lezha.gov.al> (shfletuar më: 17.05.2024).



pushtues i cili do të provonte që ta zhbënte kulturën dhe traditën e tyre dhe t'i shtynte ata drejt harresës së saj dhe kultivimit të një tradite të re. Këtë provonte ta bënte pushtuesi i tyre, Perandoria Osmane. Së paku nga pikëvështrimi antropologjik, Skënderbeu e promovonte traditën e tyre dhe i bashkonte rreth flamurit të Arbrit. Ai është mbrojtësi i pakursyer i traditës së fiseve arbërore dhe homogjenizuesi i tyre.

## ***Primordializmi***

Primordialistët i kërkonin rrënjët e përbashkëta në organizimin e hershëm familjar, herën e parë, ose në kulturë, herën e dytë.<sup>1</sup> Rrjedhimisht, dy pikëvështrime themelore mbi prejardhjen dhe formimin e kombeve e kanë kategorizuar debatin brenda tyre. Sipas grupit të parë, Pierre L. van den Berghe<sup>2</sup>-s para së gjithash, kombet janë “farefisni e zgjeruar”, ndërsa përkatësia etnike është kategori e përcaktuar historike, e cila nuk mund të ndryshohet. Ai ndikon që anëtarët e etnive të vetidentifikohen me tiparet themelore të etnisë. Ata kultivojnë të njëjtën kulturë, të cilën e bartin prej kohësh. Kësisoj, konstruktimi i etnive përgjatë historisë është pothuajse i pamundur, ose i kufizuar.<sup>3</sup>

Sipas studiuesve të grupit të dytë, ndërkaq, Clifford Geertz-it<sup>4</sup> e të tjerëve, shenjat kulturore, sikurse janë gjuha, zakonet, feja, raca dhe territori janë parashenja të formimit të kombit, por vetë kombi është produkt i “shtetit modern” dhe i krijimit të një ndërmarrjeje efikase për veten.

Megjithatë, vetëm etnosimbolistët, Anthony D. Smith më shumë se çdonjëri tjetër, arritën që “rrënjët e pashprehura” t'i kthenin në nën-

---

1. Shih: A. Smith, *Ethno-symbolism...*, e cit., fq. 9.

2. Studiues amerikan me prejardhje belge, lindur në Kongo, profesor i sociologjisë dhe i antropologjisë në Universitetin e Uashingtonit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Shih: Pierre L. van den Berghe, *The Ethnic Phenomenon* (New York: Elsevier, 1981).

3. Murat Bayar, *Primordialism*, në: <https://doi.org/10.1002/9781118430873.est0291> (shfletuar më: 15.05.2024)

4. Profesor në Institutin për Studimet e Përparuara në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, themelues i antropologjisë simbolike.

shtresë mbi të cilën zënë fill kombet. Ata nuk i shihnin ato vetëm si parashenja tejhistorike mbi të cilat mund të lindte vetëdija politike për organizim të përbashkët, por si bërthamë mbi të cilën mund të trajtohej lindja e kombeve. Jo rastësisht, lidhja e *poiesis*-it (krijimit letrar) me shenjat e trashëguara bëhej shumë e pëlqyer.

Por, para se të trajtojmë këtë raport të *marrje/dhënieve* mes letërsisë e vetëdijes kolektive për përkatësinë, le të sqarojmë se ky raport do të trajtohet duke u nisur nga pikëpamje të ngjashme me ato të Xhon Armstrongut (John Armstrong) sipas të cilit:

*Këmbëngultësia e identiteve etnike është më e rëndësishme sesa ndryshimet të cilave ato (etnitë) u ekspozohen gjatë historisë... prandaj ne duhet të përqendrohemi në shenjat dalluese simbolike, të cilat i dallojnë nga fqinjët e tyre.<sup>1</sup>*

Pra, ndryshueshmëria është historike, ndërsa artet e transformojnë atë në nënshtresë ushqyese për veten, sikundër që jo rrallë vetë ato shndërrohen në instrument motivues për etnitë. Duke qenë pjesë e një simbolike të veçantë, të ndryshme nga simbolikat e bashkësive të tjera, pra duke qenë shenjë përdalluese, sikurse e quante Smithi, ajo ndikon në krijimin e një vetëdijeje të re për vlerat e bashkësisë. Kjo që vula e etnosimbolizmit dhe pesha e saj.

## Teoritë bashkëkohore

David Miller, përfaqësues i së djathtës liberale, nënvizonte faktin se kërkesa jonë për të argumentuar të drejtën historike mund t'i lëndojë kufijtë e bashkëjetesës së kulturave dhe se përcaktimi për një kulturë të shumicës i vë në sprovë synimet e pakicave kulturore, gjuhësore ose etnike. Megjithatë, ky hamendësim merr peshë vetëm nëse ekzistenca e kombit trajtohet në raport me shtetin, si institucion politik, i cili nuk

---

1. John A. Armstrong, *Nations before Nationalism* (The University of North Carolina Press, USA, 1982). Cituar sipas: A. D. Smith, *Ethno-Symbolism and Nationalism*, e cit., fq. 23.

është gjithmonë i shtrirë njëkohshëm me kombin dhe nuk e mbulon gjithmonë plotësisht atë, ngase shteti mund të mbulojë më shumë grupe etnike, mund të mbulojë vetëm një pjesë të një kombi, sikurse vetë kombi mund të jetë i shpërndarë në disa shtete.<sup>1</sup>

Edhe sipas kësaj teorie kombi dhe shteti nuk duken të jenë çdoherë të përputhshëm dhe nuk mund të njëjtësohen. Kombi (bashkësia primordiale etnike) jeton përpara konceptit mbi shtetin, ai është strukturë e trashëguar, që ka tipare të përbashkëta, të dallueshme nga etnitë e tjera.

*Një komb duhet kuptuar si bashkësi etnike homogjene.*<sup>2</sup>

Veçse, në pikëvështrimin e Millerit dhe të liberalëve të sotëm, kombi, kjo “strukturë etnike homogjene”, është vetëm trashëgimia mbi të cilën kombet e krijojnë të ardhmen e tyre, të cilën e përcaktojnë duke u pikëprekur me trashëgimi e kultura të tjera, të cilat mund “të ndërhyjnë” në vlerat origjinare të tij dhe t’i transformojnë ato. Kësisoj, kombit primordial do t’i duhet një lloj “plebishiti i përditshëm”, çfarë kërkonte Ernest Renani, që ta krijonte fytyrën e vërtetë të tij.

*Kombet ekzistojnë kur anëtarët e tyre e njohin njëri-tjetrin si bashkatdhetarë dhe besojnë se ndajnë karakteristika të përbashkëta, të cilat janë të rëndësishme.*<sup>3</sup>

Pra, vlerat e trashëguara janë bërthama mbi të cilën homogjenizohen shoqëritë dhe e krijojnë vetëdijen “për të ngjashmin”. Por, ato i nënshtrohen vazhdimisht ballafaqimit me kulturën e secilit nga anëtarët e tij, i cili krahas përkatësisë së përbashkët (kombëtare) ruan dhe kultivon edhe “përkatësi” të tjera, të cilat janë të ndryshme për disa nga anëtarët e kësaj strukture. Përkatësia kombëtare i përfill ndryshimet dhe i stabilizon ato brenda strukturës së vet. Sipas Millerit, shembulli i amerikanëve është më përfaqësuesi. Në fillim ata qenë anglo-saksonë

---

1. Po aty, fq. 33.

2. Po aty, fq. 35.

3. Po aty, fq. 36.

si etni, por më pas ata përfshinë edhe etni të tjera brenda vetes dhe e përforcuan kuptimin për kombin amerikan.

Sido që të jetë, edhe nëse disa etni sikur ajo e anglo-saksonëve në Amerikë pikëpreken e ndryshojnë, duke u ngritur në komb mbietnik, është e pamohueshme se kombi nënkupton edhe vazhdimësi historike dhe disa vlera të trashëguara. Ajo çfarë e mban të gjallë shtysën për veprim kombëtar (këtë e trajton romantizmi) është kujtimi - kujtesa për bëmat e hershme dhe dëshira *për t'u identifikuar me njerëzit që kanë vepruar në të njëjtën kohë, duke i përvetësuar veprat e tyre si tonat.*<sup>1</sup>

Pra, nëse po themi se kombi është strukturë homogjene e trashëguar, por në të njëjtën kohë po e pranojmë faktin se ai kërkon miratimin e përditshëm të anëtarëve të tij, pyetja e pashmangshme, e cila kërkon ta sfidojë lexuesin, është nëse përkatësitë (përfshirë edhe atë kombëtare) janë të trashëgueshme apo krijohen rishtas në një “plebishit të përditshëm”? Dhe, krahas saj, a është letërsia shprehje e shpirtit të kombit, i cili flet një gjuhë dhe kultivon disa tradita të përbashkëta, apo është thjesht mjet për t'u shprehur artistikisht?<sup>2</sup> Çfarë ngjet me letërsinë e pakicave kulturore kur ato bashkëjetojnë me shumicën etnike? A bartin ato përkatësi kulturore (ose etnike) të pakicës së cilës i përkasin, apo zhvillojnë frymën e shumicës? Këtyre pyetjeve do të përpiqemi t'u japim përgjigje në kaptinën vijuese.

---

1. Po aty, fq. 37.

2. Gjuha, përpara se të jetë mjet shprehjeje e një letërsie, është shenjë dalluese, karakteri i së cilës është motivimi i përbashkët i përdoruesve të saj.